



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKT – LIGJ

NR. ____/2019, DATË ____/____/ 2019

**“PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË
QARKULLIMIT¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon detyrimin për lëshimin e faturave për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, tatimpaguesit që lëshojnë fatura, përmbajtjen e faturës, procedurat për lëshimin e faturës, detyrimin për lëshimin e faturës elektronike në transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve, ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve publike, zbatimin e procedurave të fiskalizimit të faturës, detyrimin për t’u regjistruar të prodhuesve dhe mirëmbajtësve të zgjidhjeve softuerike, procedurën e marrjes së informacionit të pagesave pa para në dorë për faturat e lëshuara, si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

¹ Ky ligj është përafshuar me: Direktivën e Parlamentit Europian dhe Këshillit 2014/55/KE, datë 16 prill 2014, “Për Faturimin Elektronik në Prokurimin Publik”, Numri CELEX 32014L0055, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 133/1, datë 6.5.2014, faqe 1–11”.

Neni 2

Fusha e veprimit

Ky ligj zbatohet për:

- a) të gjithë tatimpaguesit që lëshojnë faturë;
- b) organet publike;
- c) bankat, institucionet financiare dhe ndërmjetësit e tjerë që ofrojnë shërbime të pagesave me faturë elektronike.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllime të këtij ligji, termat e përdorur kanë kuptimin e mëposhtëm:

- a) “Faturë” kuptohet çdo dokument në letër ose në formë elektronike që përmbush kushtet e përcaktuara në këtë ligj.
- b) “Faturë elektronike” ose “e-Faturë” është fatura e lëshuar, dërguar dhe pranuar në format elektronik, që lejon përpunimin e saj automatik dhe elektronik.
- c) “Fatura shoqëruese” është dokument transporti që shoqëron lëvizjen e mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur nuk ka transferim të pronësisë mbi mallrat.
- ç) “Tatimpagues” është personi juridik, fizik apo individ, që ka detyrimin të lëshojë faturë sipas këtij ligji.
- d) Fiskalizimi i faturës për qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve, si dhe i faturës shoqëruese, nënkupton një sërë masash të cilat i zbatojnë tatimpaguesit që kanë detyrimin e lëshimit të faturave dhe faturave shoqëruese, për të mundësuar kontrollin efikas të qarkullimit, të realizuar me para në dorë dhe në forma të pagesave pa para në dorë.
- dh) “Numri identifikues i veçantë i faturës” (NIVF) dhe “Numri identifikues i veçantë i faturës shoqëruese” (NIVFSH), janë të dhëna të veçanta dhe të papërsëritshme alfanumerike të çdo fature dhe fature shoqëruese të lëshuar nga tatimpaguesi. Këto të dhëna i gjeneron sistemi informatik i administratës tatimore sipas një rregulli të caktuar, nëse përmbushen të gjitha kontrollet gjatë verifikimit të faturës dhe faturës shoqëruese.
- e) “Numri i sigurisë së lëshuesit të faturës” (NSLF) dhe “Numri i sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese” (NSLFSH), janë të dhëna të veçanta dhe të papërsëritshme alfanumerike të çdo fature dhe fature shoqëruese. Këto të dhëna i gjeneron sistemi i lëshuesit të faturës dhe faturës shoqëruese, nëpërmjet të cilit verifikohet lidhja ndërmjet lëshuesit të faturës dhe faturës së lëshuar ose ndërmjet lëshuesit të faturës shoqëruese dhe faturës shoqëruese të lëshuar.

ë) “Pagesa me para në dorë” është pagesë për mallrat ose shërbimet e kryera me kartëmonedha ose monedha, të cilat konsiderohen mjete pagese në përputhje me legjislacionin e fushës dhe, për qëllim të këtij ligji, përfshijnë edhe kartat e debitit, kreditit dhe çeqet.

f) “Pagesa pa para në dorë” është pagesë për mallra ose shërbime që kryhen nëpërmjet bankës ose institucionit të parasë elektronike të licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe që, për qëllim të këtij ligji, përfshin të gjitha mënyrat e tjera të pagesës të cilat nuk konsiderohen pagesa me para në dorë, sipas pikës “ë”, të këtij neni.

g) “Vendi i ushtrimit të veprimtarisë” konsiderohet:

- i) çdo vend i mbyllur ose i hapur dhe çdo pajisje vetëshërbimi (automat), e cila shfrytëzohet për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të mallrave apo ofrimit të shërbimeve;
- ii) një ose më shumë ambiente të një vendndodhje biznesi, në të cilën i njëjti tatimpagues që duhet të lëshojë faturë në përputhje me këtë ligj, ushtron veprimtari të ndryshme, të cilat i deklaron sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe që për qëllime të zbatimit të procedurës së fiskalizimit, mund të konsiderohen vende të veçanta të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
- iii) çdo vend të cilin tatimpaguesi e përdor për ushtrimin e përkohshëm të një veprimtarie, ose e përdor herë pas here me qëllim të organizimit të panaireve, apo aktiviteteve dhe veprimtarive të tjera të ngjashme;
- iv) çdo vend i biznesit për aktivitete të kryera në terren ose në vendndodhjen e klientit, nëse pagesa për shërbimet e kryera apo mallrat e dorëzuara bëhet me para në dorë drejtpërdrejt në vendin ku janë dorëzuar mallrat apo kryer shërbimet edhe nëse vendi i përhershëm i biznesit të atij tatimpaguesi vazhdon të operojë gjatë asaj pune në terren;
- v) çdo mjet i lëvizshëm i biznesit, që shërben për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të mallrave dhe ofrimit të shërbimeve;
- vi) vendi i regjistruar i veprimtarisë së tatimpaguesit nëse aktiviteti lidhet ekskluzivisht me shërbimet elektronike dhe në të gjitha rastet kur natyra e veprimtarisë ekonomike nuk kërkon një hapësirë veprimtarie specifike dhe të ndarë;
- vii) për qëllim të monitorimit të lëvizjes së mallrave për të cilat është lëshuar fatura shoqëruese, sipas pikës “c”, të këtij neni, do të konsiderohet si vendndodhje e biznesit çdo dyqan apo vend ku mallrat janë magazinuar dhe merren për transport.

gj) Sistemi fiskal është tërësia e pajisjeve fiskale dhe zgjidhjes softuerike që përdoren për lëshimin dhe marrjen e faturave dhe faturave shoqëruese, zbatimin e procedurës së fiskalizimit dhe shkëmbimin elektronik të mesazheve, komunikimit ndërmjet tatimpagueseve që lëshojnë fatura, fatura shoqëruese dhe sistemit të teknologjisë së informacionit të administratës tatimore, duke përdorur një rrjet të sigurtë të

shkëmbimit të të dhënave nëpërmjet lidhjes elektronike, internetit. Sistemi fiskal përfshin:

i) pajisjen fiskale, e cila përbëhet nga:

- a) pajisja elektronike e faturimit, e cila përdoret për lëshimin e faturave për shitjen e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve, me memorie fiskale për regjistrimin e të dhënave fiskale për faturat e lëshuara për pagesa që kryhen me para në dorë; dhe/ose
- b) pajisje elektronike për lëshimin e faturës shoqëruese me memorie fiskale për regjistrimin e të dhënave fiskale në faturat shoqëruese; dhe/ose
- c) printer fiskal për lëshimin e faturave nëpërmjet pajisjes elektronike të faturimit ose për lëshimin e faturës shoqëruese, në rast se printeri fiskal nuk është pjesë e pajisjes elektronike të faturimit; dhe/ose
- ç) çdo pajisje elektronike (kompjuter, telefon celular etj.) që përdoret për të përpiluar dhe lëshuar fatura për shitjen e mallrave dhe për të ofruar shërbime për pagesa që kryhen pa para në dorë;

ii) zgjidhjen softuerike, sistemin e integruar kompjuterik ose aplikacionin Cloud, që mundëson:

- a) përpilimin e faturës ose faturës shoqëruese, futjen e të gjithë elementeve të domosdoshëm të faturës ose faturës shoqëruese;
- b) identifikimin e operatorit që lëshon faturën ose faturën shoqëruese;
- c) nënshkrimin elektronik;
- ç) lëshimin dhe pranimin e faturave elektronike;
- d) transferimin automatik të të dhënave në administratën tatimore dhe pranimin e informacionit konfirmues nga administrata tatimore, pas verifikimit automatik të çdo fature ose fature shoqëruese;
- dh) ruajtjen e të dhënave në memorien fiskale;
- e) masa të tjera për procedurën e fiskalizimit;

iii) zgjidhjen softuerike, sistemin e integruar kompjuterik ose aplikacionin Cloud, që mundëson: nënshkrimin elektronik, transferimin automatik të të dhënave në administratën tatimore dhe pranimin e mesazhit konfirmues nga administrata tatimore, pas verifikimit automatik të mesazhit të pagesës së faturës elektronike;

iv) sistemin e komunikimit ndërmjet tatimpaguesit dhe administratës tatimore nëpërmjet rrjetit të sigurtë për transferimin elektronik të të dhënave nëpërmjet internetit.

h) “Operatori” është individ i cili përpilon dhe lëshon faturat nëpërmjet sistemit fiskal ose personi i autorizuar nga tatimpaguesi i lëshimit të faturave për të lëshuar fatura

Commented [A1]: A do të jetë e mundur që ky sistem të integrohet në sistemet aktuale financiare që posedojnë subjektet?

nëpërmjet sistemit fiskal. Në rastet e shitjeve nëpërmjet pajisjes së vetëshërbimit (automat), operator konsiderohet tatimpaguesi që lëshon faturën. Në rastet e lëshimit të faturës shoqëruese, operatori është individ i cili lëshon faturën shoqëruese nga pajisja elektronike.

i) “Numri unik i identifikimit” është numri personal identifikues i një individi, ose NIPT/NUIS me të cilin pajisen personat fizikë dhe juridikë, në përputhje me ligjin “Për regjistrimin e biznesit” dhe ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Për personin jorezident, i cili nuk është i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, nuk është pajisur me numrin e tij të identifikimit ose NIPT/NUIS dhe nuk është subjekt i tatimeve në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me ligjet tatimore, për qëllim të zbatimit të procedurës së fiskalizimit, numri unik i identifikimit konsiderohet numri unik i identifikimit të tatimpaguesit ose numri personal i identifikimit të individit i cili i është dhënë në vendin e tij të rezidencës.

j) Rezidentët dhe jorezidentët për qëllime tatimore, përcaktohen sipas dispozitave të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

k) Furnizimi i mallrave dhe ofrimi i shërbimeve, si dhe veprimtaria ekonomike, përcaktohen në përputhje me dispozitat e ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” si dhe me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.

l) “Platforma qendrore e faturave” e cila krijohet, zhvillohet, mirëmbahet dhe administrohet nga ana teknike nga AKSHI, ndërsa të dhënat që do të shkëmbehen përmes kësaj platforme administrohen nga Administrata Tatimore, është:

- i. një platforme e veçantë, për nevojat të zbatimit të këtij ligji, në të cilin, çdo tatimpagues që lëshon fatura regjistron informacionin e kërkuar në përputhje me këtë ligj, shqyrton të gjitha faturat e fiskalizuarat në të cilat paraqitet si blerës ose si shitës, paraqet ose shikon të gjitha pagesat e regjistruara të faturave elektronike. Disa nga tatimpaguesit që lëshojnë fatura në përputhje me këtë ligj, mund të përpilojnë fatura, të kryejnë procedurat e fiskalizimit dhe të lëshojnë faturën ose faturën elektronike dhe të dërgojnë dhe të pranojnë faturën elektronike drejtpërdrejt në këtë platforme. Çdo tatimpagues që lëshon fatura, shikon dhe mund të shqyrtojë të dhënat, në librin e shitjes dhe të blerjes, nëpërmjet llogarisë personale të krijuar në kuadër të sistemit elektronik të administratës tatimore;
- ii. ndërfaqja që mundëson ose menaxhon shkëmbimin e faturave elektronike në përputhje me këtë ligj.

ll) Nënshkrimi elektronik përcaktohet në përputhje me ligjin “Për nënshkrimin elektronik” dhe ligjin “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”.

n) Lëshuesi i detyrueshëm i faturës elektronike është personi që detyrohet të lëshojë faturë elektronike, i cili duhet të lëshojë faturat si faturë elektronike, sipas neneve 24 dhe 25, të këtij ligji. Pranuesi i detyrueshëm i faturës elektronike është blerësi sipas neneve 24 dhe 25, të këtij ligji.

KREU II
DETYRIMI PËR TË LËSHUAR FATURË

Neni 4
Tatimpaguesit që duhet të lëshojnë faturë

Tatimpaguesit që duhet të lëshojnë faturë, pavarësisht nga qarkullimi vjetor i realizuar në vitin paraardhës ose në atë aktual janë:

- a) personat juridikë dhe fizikë, të cilët janë tatimpagues të tatimit mbi fitimin, në përputhje me ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”;
- b) personat juridikë dhe fizikë të cilët janë tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, në përputhje me ligjin “Për sistemin e taksave vendore”;
- c) personat juridikë dhe fizikë të cilët, pavarësisht nga forma e organizimit, përfshirë organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve, organet publike qendrore e vendore, organizatat politike dhe institucionet e tjera të ngjashme me to, kur ushtrojnë veprimtari ekonomike sipas kuptimit në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”;
- ç) çdo person juridik, fizik, rezident ose jorezident, pavarësisht nga forma e organizimit, kur furnizon mallra ose kryen shërbime ndaj organeve publike.

Neni 5
Tatimpaguesit që përjashtohen nga detyrimi për të lëshuar faturë

1. Përjashtimisht nga neni 4, i këtij ligji, fatura nuk lëshohet nga tatimpaguesi për llojet e veprimtarive dhe për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, si më poshtë:

- a) prodhuesit bujqësorë, që operojnë sipas skemës së kompensimit të fermerit në përputhje me ligjin për TVSH-në;
- b) shitja e biletave dhe kuponave nga shoferi i mjetit të transportit në linjat e transportit urban, në përputhje me vendimet e njësive të vetëqeverisjes vendore;
- c) furnizimi i mallrave dhe shërbimeve nga persona fizikë të regjistruar në administratën tatimore si “ambulantë”;
- ç) individët në rastet kur japin me qira një ambient;

2. Krahës përjashtimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, do të zbatohet edhe përjashtimi nga detyrimi për të lëshuar faturë përcaktuar në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

KREU III LËSHIMI I FATURËS

Neni 6

Rregulla të përgjithshme për lëshimin e faturës

1. Tatimpaguesit e përcaktuar në nenin 4, të këtij ligji, janë të detyruar të lëshojnë faturë për çdo furnizim mallrash apo furnizim shërbimi, të kryer në Republikën e Shqipërisë, që është pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike përveç atyre të përjashtuara në përputhje me nenin 5 të këtij ligji.
2. Faturat e lëshuara, sipas pikës 1, të këtij neni, përdoren për kontrollin e përmbushjes së kushteve për lehtësimin e detyrimeve tatimore ose përjashtimet nga to, për perlllogaritjen e detyrimeve tatimore, në përputhje me ligjet e fushës.
3. Shitësi lëshon faturë dhe blerësi duhet ta kërkojë atë në kohën e realizimit të furnizimit së mallit apo furnizimit të shërbimit. Fatura përgatitet nga shitësi në jo më pak se dy kopje, nga të cilat njërin e merr dhe e ruan blerësi, kurse tjetrën e mban dhe e ruan shitësi. Përjashtimisht, nëse lëshohet një faturë elektronike, atëherë ajo konsiderohet origjinali i cili është në dispozicion në sistemin elektronik të shitësit dhe të blerësit.
4. Fatura mund të lëshohet edhe nga një palë e tretë, e autorizuar, në emër dhe për llogari të shitësit ose tatimpaguesit që lëshon faturë.
5. Fatura mund të lëshohet nga blerësi ose klienti i një malli apo shërbimi për furnizimet e mallrave ose shërbimeve të marra prej tij ("vetëfaturim") nga një tatimpagues nëse ka një marrëveshje paraprake midis dy palëve dhe me kushtin që të ekzistojë një procedurë për pranimin nga furnizuesi i mallit ose shërbimit të çdo fature të lëshuar për llogari dhe në emër të tij.
6. Vlerat e treguara në faturë mund të jenë të shprehura në çfarëdo lloj monedhe, me kusht që vlera totale të jetë e shprehur në vlerën ekuivalente në monedhën kombëtare shqiptare (LEK), sipas kursit të këmbimit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë në ditën e lëshimit të faturës.
7. Në rastin kur faturat për furnizimet e marra janë të hartuara në gjuhë të huaj, administrata tatimore, për qëllime të kontrollit tatimor, mund të kërkojë përkthimin autentik të faturave në gjuhën shqipe.
8. Ngarkohet Ministri përgjegjës për financat për nxjerrjen e udhëzimit përkatës për zbatimin e këtij neni.

Neni 7

Rregulla të veçanta për lëshimin e faturës

1. Tatimpaguesit që lëshojnë fatura janë të detyruar të lëshojnë fatura edhe për çdo pagesë të kryer përpara furnizimit të mallit ose përpara përfundimit të shërbimit.
2. Përveç lëshimit të faturës për çdo furnizim të mallrave ose ofrimit të shërbimeve, tatimpaguesit, subjekte të TVSH-së ose të tatimit mbi fitimin, ose të tatimit të thjeshtuar mbi

Commented [A2]: Draft ligji nuk parashikon rastet e mëposhtme të cilat hasen gjerësisht në aktivitetin ditor të bizneseve në shumë sektorë të ekonomisë dhe të cilat duhen përfshirë në të (ose udhëzimet e tij):
a.Parapagesat e mallrave/shërbimeve nga ana e blerësit para levritit të mallit (B2B) të cilat mbyllen me lëshimin e një fature ose disa faturave në mënyrë periodike të mëvonshme.
b.Situatat e "klingut", B2B, që është e përhapur në shumë sektorë të ekonomisë dhe nuk janë reflektuar në ligj se si do të veprohet.

fitimin për biznesin e vogël, në përputhje me ligjet e fushës, detyrohen të lëshojnë faturë edhe si pranues i mallrave ose shërbimeve të furnizuara kur:

a) blejnë mallra ose shërbime nga individë që nuk kanë cilësinë e tregtarit dhe që nuk janë të regjistruar në administratën tatimore si tatimpagues që lëshojnë fatura, me kusht që fatura të përmbajë përshkrimet dhe të dhënat e parashikuara në këtë ligj;

b) në kuadër të veprimtarisë ekonomike të tyre blejnë shërbime nga tatimpaguesit jashtë vendit, të cilët nuk kanë seli, vendndodhje të përhershme të biznesit, përfaqësues tatimor, vendbanim ose vendqëndrim të rregullt në Republikën e Shqipërisë, përveç nëse shitësi nga jashtë lëshon një faturë elektronike, në përputhje me standardin evropian, e cila shkëmbehet nëpërmjet platformës qendrore të faturave, në përputhje me nenin 26, të këtij ligji;

c) blejnë mallra nga prodhuesit bujqësorë, që operojnë sipas skemës së kompensimit të fermerit në përputhje me ligjin për TVSH-në.

3. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim zbatimin e këtij neni në lidhje me vetëfaturimin, në rastin e blerjes së shërbimeve nga tatimpaguesi jashtë vendit, si dhe procedurën për shkëmbimin e faturave elektronike nëpërmjet platformës qendrore të faturave, për shitësit dhe lëshuesit e faturave nga jashtë vendit.

Neni 8

Momenti i lëshimit të faturës

1. Fatura lëshohet në momentin e furnizimit të mallit ose shërbimit, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe.

2. Në rast se blerësi ose marrësi i mallrave ose shërbimeve lëshon një faturë sipas nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “c” të këtij ligji, kjo faturë lëshohet menjëherë në momentin e furnizimit të mallit ose shërbimit nga blerësi.

3. Në rast se blerësi ose marrësi i shërbimeve lëshon një faturë në përputhje me nenin 7, pika 2, shkronja “b” e këtij ligji, fatura lëshohet nga blerësi jo më vonë se data 10-të e muajit që pason muajin në të cilin është kryer shërbimi.

4. Në rast të përcaktimeve sipas nenit 7, pika 1, të këtij ligji, fatura lëshohet menjëherë, dhe jo më vonë se 24 orë pas pranimit të pagesës.

5. Fatura mund të lëshohet në mënyrë periodike për disa furnizime mallrash ose shërbimesh, të cilat furnizohen në mënyrë të rregullt ose të vazhdueshme, të realizuara midis personit të tatueshëm dhe klientit të tij në të njëjtin muaj, në të cilin furnizimet janë kryer. Në këtë rast, fatura lëshohet jo më vonë se dita e fundit e muajit përkatës për të gjitha furnizimet e kryera gjatë muajit.

6. Pika 5 e këtij neni nuk zbatohet për faturat elektronike të lëshuara në lidhje me procedurat e prokurimit publik.

7. Nëse mallrat furnizohen pa transport, atëherë shitësi duhet të lëshojë faturën në momentin kur mallrat i vihen në dispozicion blerësit.

Commented [A3]: Subjektet do të aplikojnë reverse charge me përjashtim të rasteve kur fatura nga shitësi është një faturë elektronike. Po në rastet e subjekteve të cilët ofrojnë shërbime të përjashtuara? Si do të procedohet nëse shoqëria jorezidente nga jashtë lëshon një faturë elektronike sipas standardit evropian? Si mund të verifikohet nëse fatura e shitësit është lëshuar në përputhje me standardin evropian?

Commented [A4]: Gjykojmë që afati prej 24 orësh është shumë i shkurtër. Ju lutem kini parasysh që në rastin e transfertave bankare, mund të duhet 24-48 orë për një transfertë për tu shfaqur në llogari. Për shoqëritë që mund të kenë parapafime të shpeshta, do ishte barrë e madhe të monitoronin në kohe reale pagesat për të kryer faturimin.

8. Fatura elektronike lëshohet menjëherë para transportit të mallrave nga furnizuesi tek blerësi, marrësi i dërgesës ose kur mallrat i vihen në dispozicion blerësit, nëse mallrat dorëzohen pa transport, ose në momentin e kryerjes së shërbimit ose menjëherë pas ofrimit të shërbimit.

9. Për tatimpaguesit subjekte të TVSH-së, si moment i lëshimit të faturës konsiderohet gjithashtu momenti që përcaktohet në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

KREU IV PËRMBAJTJA E FATURËS

Neni 9

Të dhënat e përgjithshme të faturës

1. Fatura e lëshuar përpilohet në formën e caktuar nga Ministri përgjegjës për financat dhe përmban, të paktën, informacionin e mëposhtëm:

- a) titullin “Faturë tatimore”;
- b) datën, vendin dhe kohën e lëshimit të faturës (orën dhe minutat);
- c) numrin e faturës;
- ç) numrin unik të identifikimit të shitësit;
- d) emrin tregtar/emrin dhe mbiemrin e shitësit;
- dh) adresën e shitësit;
- e) numrin unik të identifikimit të blerësit, emrin tregtar/emrin, mbiemrin dhe adresën e blerësit. Këto të dhëna janë të detyrueshme vetëm në rast se blerësi është:
 - i. tatimpagues, subjekt i tatimit mbi fitimin, tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, subjekt i TVSH-së, në përputhje me ligjet e fushës; ose
 - ii. person juridik; ose
 - iii. person që blen pronë personale me vlerë individuale mbi 500 000 lekë;
 - iv. në raste të tjera, kur blerësi e kërkon vetë shënimin e këtyre të dhënave në faturë.
- ë) kodin e operatorit sipas nenit 3, pika “h”, e këtij ligji, të përcaktuar në përputhje me nenin 15, të këtij ligji;
- f) kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit sipas nenit 3, pika “g”, e këtij ligji, të përcaktuar në përputhje me nenin 14, të këtij ligji;
- g) data ose periudhën, në të cilën furnizimi i mallrave ose shërbimeve është kryer, në qoftë se kjo datë ose periudhë është e ndryshme nga data e lëshimit të faturës;
- gj) sasinë dhe përshkrimin e mallrave ose shërbimeve të furnizuara dhe çmimin për njësi;

Commented [A5]: Elementet e faturës gjenerohen automatikisht nga sistemi?

h) vlerën e plotë;

i) rritjet ose zbritjet e tjera të zbatuara (informacion mbi kompensimin ose pagesën , nëse është rasti;

j) vlerën totale për t'u paguar;

k) udhëzimin e pagesës, të tillë si mënyrën e pagesës së faturës (kartëmonedha, kartë, çek, transaksion bankar, urdhër pagesë, para elektronike, mënyra të tjera të pagesës pa para në dorë), **si dhe monedhën, dhe afatin e pagesës**, në rast se pagesa nuk kryhet në çastin e lëshimit të faturës;

l) numrin identifikues të veçantë të faturës (NIVF), të shprehur si shenjë alfanumerike;

ll) numrin e sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF), të shprehur si shenjë alfa numerike; dhe

m) kodin QR që përmban të dhënat e përcaktuara me udhëzim të Ministrit përgjegjës për financat.

2. Në rast të eksportimit të mallrave jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përveç informacionit nga pika 1, të këtij neni, fatura duhet të përfshijë edhe emrin tregtar/emrin, mbiemrin dhe adresën e blerësit, nëse ai është tatimpagues ose person juridik në vendin e tij rezident, si dhe numrin e identifikimit tatimor të lëshuar në vendin e tij rezident. Nëse blerësi është individ, i cili nuk është tatimpagues në vendin e tij rezident, në faturë shënohet emri dhe mbiemri i tij dhe adresa ku dërgohen mallrat.

3. Çdo dokument në letër ose formë elektronike që ndryshon dhe i referohet në mënyrë specifike dhe të qartë faturës fillestare, konsiderohet faturë.

4. Përveç informacionit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, kur fatura lëshohet nga blerësi për furnizimin e marrë nga furnizuesi, në faturën e lëshuar duhet të shkruhet "Vetëfaturim". Në këtë rast, është e detyrueshme të përfshihen në faturë edhe informacion me numrin unik të identifikimit, emrin tregtar/emrin, mbiemrin dhe adresën e shitësit.

5. Përveç të dhënave të detyrueshme nga pika 1 e këtij neni, tatimpaguesit që lëshojnë fatura mund të shënojnë edhe të dhëna të tjera sipas nevojave të tyre.

6. Tatimpaguesit që lëshojnë faturë janë të detyruar që në faturë të paraqesin informacion të saktë dhe të plotë, në përputhje me pikën 1, të këtij neni.

7. Çdo blerësi, person juridik, fizik, ose individ, i lind e drejta të mos kryejë transaksionin për vlerën e mallit ose shërbimit të ofruar, nëse shitësi nuk lëshon faturën me të gjitha të dhënat e detyrueshme përcaktuara me këtë ligj.

8. NIVF dhe NSLF, së bashku me informacionet e tjera të detyrueshme sipas këtij neni, printohen në faturë nga pajisja elektronike e faturimit, ose përfshihen në faturën elektronike. Ministri përgjegjës për financat, me udhëzim, përcakton mënyrën e gjenerimit, gjatësinë dhe llojin e të dhënave për NIVF dhe NSLF.

Commented [A6]: Po nëse për transaksione të ndryshme nuk është e përcaktuar data e pagesës? Kjo pikë do të jetë e detyrueshme?

9. Fatura që nuk është lëshuar ose për të cilën nuk është kryer procedura e fiskalizimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, nuk njihet si një dokument i vlefshëm për qëllime tatimore për një blerës që kryen aktivitet tregtar.

10. Përveç përshkrimeve dhe të dhënave, të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, fatura me TVSH përmban të dhënat e përcaktuara në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

11. Ministri përgjegjës për financat, me udhëzim, mund të përcaktojë kërkesa të tjera, që duhet të përmbajë një faturë, për rastet që rrjedhin nga veçoritë e veprimtarive të zhvilluara, të sendeve të tregtueshme, të punimeve apo të shërbimeve.

Neni 10

Të dhënat shtesë për faturën elektronike

1. Përveç përshkrimeve dhe të dhënave, të parashikuara në nenin 9 këtij ligji, fatura elektronike përmban të dhënat mbi procesin dhe identifikuesit e faturës dhe nëse është e aplikueshme të dhënat e mëposhtme:

- a) të dhënat e përfituesit të pagesës;
- b) të dhënat e përfaqësuesit tatimor të shitësit, nëse ka;
- c) referencën e kontratës;
- ç) të dhënat e dorëzimit.

2. Ministri përgjegjës për financat me udhëzim përcakton elementet teknike, dhe procedurën për lëshimin dhe shkëmbimin e faturave elektronike dhe dokumenteve shoqëruese.

Neni 11

Fatura e thjeshtë

1. Përjashtimisht nga neni 9 i këtij ligji, tatimpaguesit që lëshojnë fatura, që i nënshtrohen regjimit të bizneseve të vogla, sipas përcaktimeve të ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” për furnizimin e mallave dhe shërbimeve të paguar me para në dorë në kohën e dërgimit të mallrave ose shërbimeve, të lëshojnë një faturë të thjeshtuar, e cila duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- a) titullin “Faturë-Th”;
- b) numrin e faturës;
- c) kodin e operatorit sipas nenit 3, pika “h”, e këtij ligji, e lëshuar në përputhje me nenin 15 të këtij ligji;
- ç) kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit sipas nenit 3, pika “g”, e këtij ligji, të përcaktuar në përputhje me nenin 14, të këtij ligji;

Commented [A7]: Si do të kryhet verifikimi nëse për faturën që është lëshuar është kryer procedura e fiskalizimit? Për çdo faturë të marrë do të bëhet verifikimi në sistemin tatimor?

- d) mënyrën e pagesës së faturës (kartëmonedha, kartë, çek) dhe monedhën;
- dh) NIVF-në;
- e) NSLF-në;
- ë) kohën (orën dhe minutat) dhe vendin e lëshimit të faturës;
- f) identifikimin e shitësit (numrin identifikues unik, emrin tregtar/emrin dhe mbiemrin, adresën);
- g) identifikimin e blerësit (numrin identifikues unik, emrin tregtar/emrin dhe mbiemrin). Këto të dhëna janë të detyrueshme vetëm në rast se blerësi është tatimpagues, subjekt i tatimit mbi fitimin, tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, subjekt i TVSH-së në përputhje me ligjet e veçanta ose është person juridik që është furnizuar me mallra ose shërbime në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë së tij ekonomike; ose në raste të tjera kur blerësi kërkon vetë shënimin e këtyre të dhënave në faturë;
- gj) sasinë dhe përshkrimin e mallrave ose shërbimeve të furnizuara, çmimin për njësi;
- h) vlerën totale të faturës; dhe
- i) kodin QR që përmban të dhënat e përcaktuara me udhëzim të Ministrit përgjegjës për financat.

2. Në rast kur fatura lëshohet në letër nuk është e nevojshme të shfaqen të dhënat sipas pikës 1, shkronjës “b” deri në “d” të këtij neni, sepse blerësi mund t’i aksesojë ato nëpërmjet kodit QR në përputhje me pikën 1, shkronja “i” e këtij neni.

Neni 12

Numri i faturës

1. Numrin e faturës, i cili sipas dispozitave të nenit 9 të këtij ligji është pjesë përbërëse e faturës, tatimpaguesit që lëshojnë fatura duhet ta paraqesin në fushën “numri i faturës”, gjatë zbatimit të procedurës së fiskalizimit, në dy pjesë:

- a) renditja numerike e numrit të faturës; dhe
- b) kodi i pajisjes elektronike të faturimit.

2. Rënditja numerike e numrit të faturës duhet të formohet si një renditje numerike e pandërprerë, pa hapësira ndërmjet numrave, për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë të biznesit ose pajisje elektronike të faturimit që ndodhet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit. **Rregullat e renditjes numerike të numrit të faturës duhet të përshkruhen nga tatimpaguesi që lëshon fatura, në një akt të brendshëm.**

3. Rënditja numerike e pandërprerë e çdo viti kalendarik fillon nga numri 1 deri në numrin n, për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë të biznesit ose pajisje elektronike të faturimit që ndodhet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit.

Commented [A8]: Nga sa karaktere do të përbëhet numri rendor i faturës? Do merret miratim nga DPT për numrin rendor?

4. Kodi i pajisjes elektronike të faturimit gjenerohet nga sistemi informatik i administratës tatimore në momentin e testimit të parë gjatë regjistrimit të pajisjes elektronike të faturimit, i cili duhet të kryhet jo më vonë se 24 orë përpara lëshimit të faturës nga ajo pajisje elektronike faturimi. Ndër elementët e tjerë që duhet të përmbajë ky test hyrje, përcaktuar në udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat, përfshihet gjithashtu kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë të biznesit ku do të përdoret pajisja elektronike e faturimit.

5. Numri i faturës tregohet pa shenja, të përshkruara në pikën 1, shkronja “b”, e këtij neni, në rastet e mëposhtme:

- a) në rastin e lëshimit të faturës për të cilën është parashikuar pagesa pa para në dorë;
- b) në rastin e përpilimit dhe lëshimit të faturës nëpërmjet platformës qendrore të faturave, në përputhje me nenin 22 të këtij ligji;
- c) në rastin e “vetëfaturimit” sipas nenit 7, pika 2 e këtij ligji.

6. Ministri përgjegjës për financat me udhëzim përcakton zbatimin e këtij neni.

KREU V

REGJISTRIMI I TË DHËNAVE

Neni 13

Detyrimi për t’u regjistruar për lëshimin e faturës

1. Tatimpaguesit, të cilët në datën 31.12.2019, janë të regjistruar si tatimpagues aktivë në administratën tatimore dhe që janë subjekt i lëshimit të faturave sipas nenit 4 të këtij ligji, caktohen automatikisht në regjistrin e tatimpaguesve që mban administrata tatimore si tatimpagues që lëshojnë fatura.

2. Nga data 1.1.2020, të gjithë tatimpaguesit e rinj të cilët do të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Bisnesit, caktohen automatikisht si tatimpagues që lëshojnë faturë në regjistrin e tatimpaguesve që mban administrata tatimore.

3. Për të gjithë tatimpaguesit e rinj të cilët regjistrohen tek administrata tatimore, pas datës 1.1.2020, regjistrimi i tyre në regjistrin e tatimpaguesve që lëshojnë faturë, bëhet automatikisht nga administrata tatimore ose në bazë të kërkesës së tatimpaguesit. Kërkesa bëhet në rrugë elektronike nëpërmjet platformës qendrore të faturave, apo në raste të veçanta, personalisht në drejtoritë rajonale, sipas vendit të regjistrimit, vendbanimit ose vendqëndrimit të rregullt, me fillimin e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve mbi bazën e të cilit do të bëhen subjekt i lëshimit të faturave, në përputhje me këtë ligj, dhe jo më vonë se 24 orë përpara lëshimit të faturës së parë.

4. Administrata tatimore, për të gjithë personat e pikës 3 të këtij neni, kryen regjistrimin e detyrimit të tyre për lëshim të faturave në regjistrin e saj. Në këtë rast, tatimpaguesi nuk do të pajiset me vërtetim apo numër fiskal të veçantë, por gjatë lëshimit të faturave, ai do të përdorë numrin unik të identifikimit të tij.

Neni 14

Regjistrimi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit dhe i pajisjeve elektronike e faturimit

1. Tatimpaguesi që lëshon fatura, detyrohet që të paraqesë nëpërmjet platformës qendrore të faturave, të dhënat për vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, në përputhje me nenin 3, pika “g”, të këtij ligji, por jo më vonë se 24 orë përpara fillimit të lëshimit të faturës sipas këtij ligji në çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit.

2. Me qëllim të zbatimit të procedurës së fiskalizimit të lëshimit të faturave, regjistrimi sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të përmbajë së paku të dhënat e mëposhtme:

- a) numrin unik të identifikimit të tatimpaguesit që lëshon faturën;
- b) emrin tregtar të vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, nëse ka;
- c) adresën e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
- ç) llojin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
- d) llojin e veprimtarive që ushtron në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
- dh) orarin ditor të punës dhe ditët e punës gjatë javës, punën gjatë festave zyrtare;
- e) datën e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
- ë) datën e mbylljes së veprimtarisë në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, duke përfshirë datat e ndërprerjes së përkohshme;
- f) sipërfaqen e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, kur kjo është e mundur;
- g) mënyrën nëpërmjet së cilës blerësit mund të paguajnë për mallrat ose shërbimet në atë vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit (me para në dorë dhe/ose pa para në dorë);
- gj) statusin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
- h) emrin e ofruesit të lidhjes elektronike (internetit);
- i) shënimin nëse vendi i ushtrimit të veprimtarisë së biznesit është në pronësi ose me qira.

3. Tatimpaguesi që lëshon faturë, të dhënat për llojin e veprimtarive që ushtron në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, sipas pikës 2, shkronja “d”, të këtij neni, i paraqet sipas përcaktimeve të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike në fuqi.

4. Me përjashtim të pikës 1, të këtij neni, nëse tatimpaguesi që lëshon fatura, për arsye të justifikuar nuk mund të përdorë platformën qendrore të faturave, të dhënat nga pika 2 e këtij neni, i dërgon sipas vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit të secilit biznes nëpërmjet një formulari të veçantë, drejtpërdrejt në zyrën e tatimeve të administratës tatimore ku është i regjistruar, apo ka vendbanimin ose vendqëndrimin e rregullt.

Commented [A9]: Mendojmë se është një informacion i tepërt pasi është një e dhënë variabël që ndryshon vazhdimisht sipas nevojave dhe kërkesave të biznesit.

Commented [A10]: Të dhëna për kompaninë e internetit? Do të ketë shoqëria që ofron shërbime interneti ndonjë detyrim për ruajtjen e informacionit?

5. Nëse ndryshohen të dhënat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, për vendin e caktuar të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, tatimpaguesi që lëshon faturë, detyrohet që përpara fillimit të aplikimit të të dhënave të ndryshuara, të paraqesë të dhënat për ndryshimet e kryera në mënyrën e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, ose në raste të veçanta, në përputhje me pikën 4 të këtij neni, jo më vonë se 24 orë përpara fillimit të aplikimit të të dhënave të ndryshuara.

6. Pas regjistrimit të të dhënave, sistemi informatik i administratës tatimore gjeneron kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit. Administrata tatimore i jep në formë elektronike tatimpaguesit që lëshon fatura certifikatën e regjistrimit dhe kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit. Kjo certifikatë regjistrimi ruhet në platforma qendrore e faturave, në llogarinë e përdoruesit të tatimpaguesit që lëshon fatura.

7. Përveç paraqitjes së të dhënave për vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, përpara fillimit të lëshimit të faturave, tatimpaguesi që lëshon fatura, duhet të regjistrojë çdo pajisje elektronike të faturimit, në përputhje me nenin 12, pika 4, të këtij ligji. Përgjashtimisht, nëse tatimpaguesi që lëshon fatura, për arsye të justifikuar, nuk mund të kryejë regjistrimin testues nga pajisja fiskale në sistemin fiskal, ai mund të përdorë platformën qendrore të faturave për këtë regjistrim, ose mund të dërgojë të dhënat për secilën pajisje fiskale, nëpërmjet formularit të posaçëm, drejtpërdrejt në zyrën përkatëse të administratës tatimore ku është i regjistruar, apo ka vendbanimin ose vendqëndrimin e zakonshëm.

8. Administrata tatimore mban të dhënat e të gjitha pajisjeve elektronike të faturimit të paraqitura. Tatimpaguesi që lëshon fatura, detyrohet, që në rast të ndërprerjes së përhershme të punës së pajisjes elektronike të faturimit, për arsye të zëvendësimit të pajisjes me një të re si rezultat i prishjes, vjedhjes, apo çdo arsye tjetër, ta informojë administratën tatimore, në përputhje me pikën 5, të këtij neni.

9. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim të dhënat, formën dhe procedurën për paraqitjen e të dhënave të përcaktuara në këtë nen.

Neni 15

Regjistrimi i operatorëve

1. Tatimpaguesi që lëshon fatura, detyrohet që të paraqesë në administratën tatimore nëpërmjet shërbimit elektronik të dhënat për çdo operator, në përputhje me nenin 3, pika “h”, e këtij ligji, përfshirë informacionin mbi numrin unik të identifikimit dhe emrin e operatorit, por jo më vonë se 24 orë para lëshimit të faturave nga secili operator.

2. Me përjashtim të pikës 1, të këtij neni, nëse tatimpaguesi që lëshon fatura, për arsye të justifikuar nuk mund të përdorë platformën qendrore të faturave, të dhënat nga pika 1 e këtij neni, i dërgon për secilin operator nëpërmjet një formulari të veçantë, drejtpërdrejt në zyrën rajonale të administratës tatimore ku është i regjistruar, ku ka adresën e përhershme, ose vendbanimin e zakonshëm.

3. Pas regjistrimit të të dhënave, sistemi i administratës tatimore do të gjenerojë kodin e operatorit, i cili do të shoqërohet me numrin e tij personal të identifikimit, nëse operatori është individ, ose me NIPT/NUIS, nëse është tatimpagues që ofron shërbime konsulence

fiskale, tatimore, apo kontabiliteti. Përjashtimisht, për pajisjet e vetëshërbimit (automat), kodi i operatorit do të lidhet me numrin unik të identifikimit të tatimpaguesit që lëshon faturë.

4. Administrata tatimore i jep në formë elektronike operatorit certifikatën e regjistrimit dhe kodin. Kjo certifikatë regjistrimi ruhet në platformen qendrore të faturave, në llogarinë e përdoruesit të tatimpaguesit që lëshon faturë.

5. Nëse një pajisje elektronike e faturimit përdoret nga më shumë se një operator për përpilimin dhe lëshimin e faturave, secili operator, si lëshues i faturës, duhet të identifikohet në sistemin fiskal me anë të kodit të caktuar për çdo faturë që lëshon.

6. Tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të paraqesë në administratën tatimore informacionin për çdo ndryshim të të dhënave të operatorëve në mënyrën e përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, brenda 24 orëve pas bërjes së ndryshimit.

7. Nëse një person është operator i autorizuar për lëshim të faturave për dy ose më shumë tatimpagues që lëshojnë fatura, ai do të përdorë të njëjtin kod kur futet në sistemin fiskal.

8. Një operator mund të futet në sistemin fiskal dhe të fillojë lëshimin e faturave në emër dhe për llogari të tatimpaguesit të caktuar që lëshon fatura, vetëm nëse tatimpaguesi e ka regjistruar atë si operator të tij, në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

9. Ministri përgjegjës për financat me udhëzim përcakton formularin dhe procedurën për paraqitjen e të dhënave për operatorët e përcaktuar në këtë nen.

Neni 16

Regjistrimi i prodhuesve dhe mirëmbajtësve të softuerëve

1. Përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së ofrimit të zgjidhjeve softuerike ose shërbimeve të mirëmbajtjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, prodhuesit dhe mirëmbajtësit e zgjidhjeve softuerike të përcaktuar në nenin 3, pika “gj”, nënpikat “ii” dhe “iii” të këtij ligji, duhet të regjistrohen në mënyrë elektronike në regjistrin e prodhuesve dhe mirëmbajtësve softuerikë të AKSHI-t duke përdorur platformën qendrore të faturave të kësaj të fundit.

2. Prodhuesi dhe/ose mirëmbajtësi i zgjidhjes softuerike të përcaktuar në nenin 3, pika “gj”, nënpikat “ii” dhe “iii” të këtij ligji, detyrohen të certifikohen nga AKSHI dhe administrata tatimore për zgjidhjen teknike përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së ofrimit të kësaj zgjidhje softuerike ose shërbimeve të mirëmbajtjes në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Subjektet e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, duhet të regjistrojnë tek AKSHI në mënyrën e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni edhe informacionin mbi zgjidhjet e veta softuerike.

4. Regjistrimi sipas pikës 1 të këtij neni nuk e zëvendëson detyrimin për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit apo administratën tatimore të subjekteve, të cilët ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare në përputhje me legjislacionin në fuqi, apo aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Pas regjistrimit, sistemi informatik i AKSHI-t gjeneron kodin e subjektit të referuar nën pikën 1 të këtij neni dhe kodin e zgjidhjes softuerike. Këto kode duhet të integrohen në zgjidhjen softuerike nga prodhuesit e softuerëve përpara dorëzimit tek tatimpaguesi që lëshon faturë, në mënyrë që sistemi fiskal të identifikojë prodhuesin dhe vetë zgjidhjen softuerike gjatë çdo dërgimi të faturave në procedurën e fiskalizimit..

6. AKSHI i jep në formë elektronike subjektit të përcaktuar nën pikën 1 të këtij neni certifikatën dhe kodin e regjistrimit të zgjidhjes softuerike. Kjo certifikatë ruhet në platformën qendrore e faturë-s, në llogarinë e përdoruesit të subjektit.

7. Tatimpaguesi që lëshon faturë nuk mund të lëshojë fatura, nëse prodhuesi i softuerit dhe zgjidhja softuerike që përdor, nuk janë regjistruar dhe certifikuar në regjistrin e përcaktuar në pikën 1, dhe 2, të këtij neni. Për këtë qëllim, çdo tatimpagues që lëshon faturë mund të kontrollojë nëpërmjet emërimit/emrit dhe mbiemrit apo numrit unik të identifikimit të prodhuesit të softuerit, nëse ai prodhues dhe zgjidhja softuerike janë të regjistruar në regjistrin.

8. Tatimpaguesi që lëshon faturë duhet të dorëzojë në mënyrë elektronike të dhënat për mirëmbajtësin e zgjidhjeve softuerike të referuar në pikën 1 të këtij neni, duke përdorur platformën qendrore të faturave.

9. Tatimpaguesi që lëshon faturë dhe prodhuesi ose mirëmbajtësi i softuerit janë përgjegjës për funksionalitetin e zgjidhjes softuerike të përcaktuar në nenin 3, pika “gj”, nënparagrafi “ii” dhe “iii” të këtij ligji. Për këtë qëllim, çdo prodhues dhe mirëmbajtës i softuerit që është regjistruar në regjistrin sipas pikës 1 të këtij neni, nëpërmjet platformën qendrore e faturave mund të verifikojë listën me emrin dhe numrin unik të identifikimit për të gjithë tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes së tyre softuerike ose që kanë dhënë informacion që ato përdorin shërbimet e tyre të mirëmbajtjes.

10. Procedurat për zbatimin e këtij neni përcaktohen me urdhër të përbashkët të Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Neni 17

Regjistrimi i faturave në librin e shitjes dhe librin e blerjes

1. Duke u mbështetur në të dhënat e paraqitura në administratën tatimore për të gjitha faturat e shitjeve dhe blerjeve, nëpërmjet procedurës së fiskalizimit të faturave, për çdo tatimpagues që lëshon faturë në pajtim me këtë ligj, sistemi informatik i administratës tatimore do të gjenerojë një libër të shitjes dhe një libër të blerjes, të cilët do të jenë në dispozicion në platformën qendrore të faturave, në llogarinë e përdoruesit të tatimpaguesit që lëshon faturë.

2. Çdo tatimpagues që lëshon faturë detyrohet që të shqyrtojë të dhënat në librin e shitjes dhe librin e blerjes të përmendur në pikën 1 të këtij neni, deri në ditën e 10 të muajit, për muajin paraardhës, dhe nëse është e nevojshme t'i ndryshojë ose përditësojë ato të dhëna, me përjashtim të vlerave, si dhe pas përfundimit të kësaj procedure, të konfirmojë saktësinë e të dhënave.

Commented [A11]: Mund të shkarkohen në excel nga platforma në formatin e librave dhe të bëhen rregullimit/shtim të faturave dhe të dorëzohet në e-Tax?

Commented [A12]: Librat do të gjenerohen nga sistemi qendror. Si mund të përfshihen transaksione të cilat nuk janë raportuar për arsye të ndryshme? Si do të procedohet me regjistrimin e deklaratave të doganës apo deklarata të eksporteve?

3. Libri i shitjes dhe libri i blerjes në platformën qendrore të faturave, duhet të jenë në dispozicion të tatimpaguesit që lëshon faturë gjatë gjithë afatit kohor të përcaktuar për ruajtjen e faturave, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

4. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim procedurat për ndryshimin dhe plotësimin e të dhënave në librin e shitjes dhe librin e blerjes dhe procedurat e tjera të përcaktuara nga ky nen.

KREU VI

PROCEDURA E FISKALIZIMIT TË FATURAVE

Neni 18

Pajisjet fiskale dhe zgjidhja softuerike për zbatimin e procedurës së fiskalizimit

1. Të gjithë tatimpaguesit që lëshojnë fatura, të cilët shesin mallra në aktivitetin e shitjes me pakicë, ose ofrojnë shërbime, në vende apo njësi të hapura për publikun ose kryejnë çfarëdo veprimtarie tjetër ekonomike, dhe për furnizimin e këtyre mallrave ose shërbimeve lëshojnë fatura të paguara me para në dorë, duhet të instalojnë pajisjet elektronike të faturimit apo të sigurojnë pajisje të lëvizshme elektronike të faturimit dhe printer (nëse kjo pajisje dhe printeri nuk janë të integruara), apo të përdorin zgjidhjen e certifikuar softuerike sipas nenit 3, pika “gj”, e këtij ligji të shoqëruar me një pajisje printimi, për shtypjen e faturave, përveç nëse ata kryejnë ekskluzivisht veprimtari dhe shesin mallra dhe shërbime të cilat janë të përjashtuara nga detyrimi i lëshimit të faturës, në përputhje me nenin 5, të këtij ligji.

2. Tatimpaguesi që lëshon faturë, për qëllim të zbatimit të procedurës së fiskalizimit të faturës së lëshuar, detyrohet që për çdo transaksion të lëshojë faturë nëpërmjet njëres prej zgjidhjeve të kombinuara, në përputhje me pikën 1, të këtij neni.

3. Secila prej zgjidhjeve të kombinuara të përmendura në pikën 1, të këtij neni, të mundësojë lidhjen me internet për shkëmbimin elektronik të të dhënave me administratën tatimore.

4. Të gjithë tatimpaguesit e tjerë që lëshojnë fatura, duhet të sigurojnë pajisjet fiskale të përmendura në nenin 3, pika “gj”, të këtij ligji, që do të mundësojnë përdorimin e zgjidhjes softuerike të certifikuar të përmendur nën të njëjtin nen dhe lidhjen me internet për shkëmbimin elektronik të të dhënave me administratën tatimore, me qëllim të zbatimit të procedurës së fiskalizimit për lëshimin e faturave.

5. Tatimpaguesit që lëshojnë fatura, për qëllim të zbatimit të procedurës së fiskalizimit të faturave, duhet të përdorin një zgjidhje softuerike të certifikuar që u mundëson të veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, pra, zgjidhje softuerike të certifikuar që pamundësojnë veprimet që shmangin procedurën e fiskalizimit të faturës.

6. Me qëllim të zbatimit të pikës 5, të këtij neni, tatimpaguesi që lëshon faturë mund të testojë të dhënat nga fatura dhe procedurën e fiskalizimit, ndërsa metoda e testimit do të përcaktohet nga Ministri përgjegjës për financat me udhëzim.

Commented [A13]: -Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, a do të jetë më e nevojshme deklarimi i librave të TVSH në e-Tax?

-Platforma qendrore e faturave do të jetë e lidhur me sistemin e-tax? Pas miratimit nga ana e tatimpaguesit të librave në platformë, a mund të dërgohet informacion në e-tax?

Commented [A14]: Mund të përdoren programet financiare që mund të disponojnë tatimpaguesit si psh. F5, Alpha, Bilanci etj?

Neni 19

Certifikata elektronike

1. Tatimpaguesi që lëshon faturë, detyrohet që me qëllim të zbatimit të procedurës së fiskalizimit të faturës, të marrë një certifikatë elektronike, e cila gjenerohet dhe lëshohet nga AKSHI si institucioni qendror shtetëror që administron dhe mirëmban Infrastrukturën Qeveritare të Çelësave Publike.
2. Certifikata elektronike e lëshuar nga AKSHI ruhet në një ambient fizik me nivel të lartë sigurie, duke mos cenuar integritetin e tyre dhe thyer konfidencialitetin e tyre.
3. Për certifikatën elektronike të lëshuar do të aplikohet tarifa e përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave për shërbimet elektronike të ofruara nga AKSHI për subjektet nën pikën 1, të këtij neni.

Commented [A15]: Kjo tarifë do të paguhet një herë për certifikatën elektronike apo çdo vit fiskal?

Neni 20

Zbatimi i procedurës së fiskalizimit të faturës

1. Tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të nënshkruajë në mënyrë elektronike çdo faturë të lëshuar dhe ta dërgojë atë në administratën tatimore, nëpërmjet lidhjes me internet. Ministri përgjegjës për financat, me udhëzim përcakton formën, përmbajtjen dhe strukturën e mesazheve me elementet e faturës që duhet të dërgohen në administratën tatimore.
2. Administrata tatimore kontrollon nëse janë dërguar të gjitha elementet e përcaktuara të faturës, nëse ajo është e nënshkruar elektronikisht, sipas nenit 19 të këtij ligji, dhe kryen kontrolle të tjera mbi saktësinë e faturës.
3. Nëse kushtet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, përmbushen plotësisht, administrata tatimore gjeneron NIVF-në dhe ia kthen atë tatimpaguesit që ka lëshuar faturën nëpërmjet lidhjes elektronike të vendosur (internet).
4. Nëse kushtet nga pika 2, e këtij neni, nuk përmbushen, administrata tatimore nuk mund ta përcaktojë NIVF-në dhe, në këtë rast, i kthen tatimpaguesit që lëshon faturën një mesazh mbi refuzimin e përcaktimit të NIVF-së, nëpërmjet lidhjes elektronike të vendosur (internet).
5. Vetëm pas zbatimit të procedurës së fiskalizimit, mund të lëshohet fatura dhe t'i dorëzohet blerësit, ndërsa NIVF, si një e dhënë e detyrueshme në faturë, nënkupton që procedura e fiskalizimit është kryer me sukses. Përgjashtimisht, një faturë mund të lëshohet pa NIVF, vetëm në rastet e përmendura në nenet 29, 30 dhe 31, të këtij ligji.
6. Subjektet e "vetëfaturimit" duhet të zbatojnë procedurën e fiskalizimit në mënyrën e përshkruar në pikat 1 deri 5, të këtij neni.
7. Blerësit, të cilët janë tatimpagues, subjekte të TVSH-së, ose të tatimit mbi fitimin ose tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, në përputhje me ligjet e fushës, kur marrin një faturë për importin e mallrave nga një shitës nga jashtë vendit ose një faturë elektronike për shërbime të marra nga një tatimpagues nga jashtë vendit, i cili nuk është subjekt i lëshimit të faturave sipas këtij ligji, duhet të zbatojnë procedurën e fiskalizimit në mënyrën e përshkruar në pikat 1 deri 5, të këtij neni.

Commented [A16]: Tatimpaguesi do të fiskalizojë dhe procesin për faturat e blerjes? Si do të procedohet për këto raste?

8. Procedura e fiskalizimit të faturës, në rast të “vetëfaturimit”, sipas nenit 6, pika 5, të këtij ligji, kryhet menjëherë në kohën e “vetëfaturimit”, sipas afateve të përcaktuara në nenin 8, të këtij ligji.

9. Procedura e fiskalizimit të faturës, në rast të “vetëfaturimit”, sipas nenit 7, pika 2, të këtij ligji, kryhet menjëherë në kohën e “vetëfaturimit”, dhe jo më vonë se afati i përcaktuar në nenin 8, pika 2 dhe 3, të këtij ligji.

10. Procedura e fiskalizimit të faturës për importet e mallrave, në rastin e pranimit të faturës së shitësit i cili ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas pikës 7 të këtij neni, kryhet nga marrësi i mallrave në Republikën e Shqipërisë pas lejimit në qarkullim të lirë, por jo më vonë se tre ditë nga kryerja e importimit. Në rastin e furnizimit nga jashtë të shërbimeve, blerësi vendas i shërbimeve që ka marrë një faturë elektronike nga jashtë shtetit, kryen procedurën e fiskalizimit brenda afatit të referuar në nenin 8, pika 3 e këtij ligji. Ministri përgjegjës për financat, përcakton me udhëzim, procedurën dhe mekanizmat për zbatimin e kësaj pike dhe të dhënat shtesë të kërkuara sipas këtij ligji.

11. Specifikimet teknike të zgjidhjes softuerike do të përcaktohen me urdhër të përbashkët të Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Neni 21

Shitjet nëpërmjet pajisjeve të vetëshërbimit (automat)

1. Për zbatimin e procedurës së fiskalizimit të shitjeve nëpërmjet pajisjeve të vetëshërbimit (automat), tatimpaguesi që lëshon faturë, detyrohet të fiskalizojë çdo shitje në momentin e shitjes, nëpërmjet dërgimit të të dhënave të shitjes në administratën tatimore.

2. Tatimpaguesi që lëshon faturë, sipas pikës 1, të këtij neni, është i detyruar të mundësojë përdorimin e softuerit për nënshkrimin elektronik të mesazheve mbi shitjen, si dhe të sigurojë lidhjen me internet për shkëmbimin elektronik të të dhënave me administratën tatimore për zbatimin e procedurës së fiskalizimit të shitjeve nëpërmjet pajisjeve të vetëshërbimit.

3. Pavarësisht nga neni 6, pika 4, e këtij ligji, dërgimi i të dhënave mbi shitjet në administratën tatimore, në përputhje me pikat 1 dhe 2, të këtij neni, konsiderohet që të ketë përmbushur detyrimin e lëshimit të faturës sipas këtij ligji, dhe fatura nuk ka nevojë të printohet dhe t’i dorëzohet blerësit, përveç nëse kërkohet për tatimpagues të cilët operojnë në sektorë të veçantë të ekonomisë, në përputhje me udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat. Në këtë rast të fundit, printohet një faturë e thjeshtë, sipas nenit 11, të këtij ligji.

4. Specifikimet teknike të zgjidhjes softuerike për qëllimin e zbatimit të fiskalizimit të shitjeve nga pajisjet e vetëshërbimit (automatë) do të përcaktohen me urdhër të përbashkët të Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve

Neni 22

Procedurë e veçantë për fiskalizimin e tatimpaguesve të klasifikuar si biznes i vogël

1. Me përjashtim të neneve 16, 18 dhe 20, të këtij ligji, tatimpaguesit që lëshojnë faturë, të cilët në përputhje me ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, konsiderohen subjekt të regjimit të bizneseve të vogla, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave nuk kanë nevojë të instalojnë pajisje të

Commented [A17]: Si do të raportohet në sistem? Këto të dhëna do të futen manualisht në sistem apo do të merren automatikisht nga sistemi i doganave?

veçanta elektronike të faturimit, as zgjidhje të veçantë softuerike për zbatimin e procedurës së fiskalizimit, as të paraqesin informacion në lidhje me mirëmbajtjen e zgjidhjes softuerike, por mund të përpilojnë fatura të thjeshta, sipas nenit 11, të këtij ligji, dhe të zbatojnë procedurën e fiskalizimit, nëpërmjet platformës qendrore të faturave.

2. Tatimpaguesi që lëshon faturë, faturat e referuara në pikën 1, të këtij neni, duhet t'i printojë në letër dhe t'ia dorëzojë blerësit, ose t'ia dërgojë nëpërmjet postës elektronike, në dakordësi me të.

3. AKSHI lëshon certifikatën elektronike, sipas nenit 19, të këtij ligji për subjektet nëpikën 1

4. Ministri përgjegjës për financat, me udhëzim, përcakton procedurën e aksesimit, përpilimit dhe fiskalizimit të faturës, sipas pikës 1, të këtij neni.

5. Këshilli i Ministrave mund të kufizojë me vendim sektorin e biznesit që do të përjashtohet nga detyrimi nën pikën 1 të këtij neni.

Commented [A18]: Subjektet e biznesit të vogël me TVSH, do të kenë detyrimin vetëm të lëshojnë faturë të thjeshtë dhe dorëzimin e tyre në platformën e faturave. Si do të lëshohet fatura e thjeshtë nëse nuk do të instalohen pajisjet e veçanta? Platforma qendrore e faturave do të mundësojë lëshimin e faturave online duke mos pasur nevojë për pajisje të veçanta? Si do të bëhet printimi i tyre?

KREU VII

MËNYRA E LËSHIMIT DHE DËRGIMIT TË FATURËS

Neni 23

Fatura për pagesë me para në dorë

1. Fatura për pagesat me para në dorë, duhet të printohet në letër me të gjitha të dhënat e nevojshme të faturës dhe t'i nënshtrohet procedurës së fiskalizimit, sipas këtij ligji, dhe t'i dorëzohet blerësit në momentin e furnizimit të mallrave ose shërbimeve.

2. Përjashtimisht nga pika 1, e këtij neni, nëse ofrohet një shërbim elektronik ose furnizimi i mallrave ose shërbimeve kontraktohet dhe paguhet nëpërmjet një aplikacioni celular, ose dyqani në internet apo të ngjashme, fatura nuk ka nevojë të printohet në letër, por mund t'i dërgohet blerësit ose marrësit të faturës, nëpërmjet postës elektronike (*e-mail*) ose si faturë elektronike.

3. Nëse blerësi është individ ose person i cili nuk është tatimpagues që lëshon faturë, sipas nenit 4, të këtij ligji, atëherë dërgimi i faturës, sipas pikës 2, të këtij neni, mund të kryhet vetëm me pëlqimin e tij. Për blerësit e tjerë, në rastin e referuar sipas pikës 2, të këtij neni, fatura elektronike mund të lëshohet pa pëlqim të veçantë nga blerësi, në përputhje me nenin 28, të këtij ligji, nëse blerësi është i regjistruar në platformën qendrore të faturave, të përmendur në nenin 26, të këtij ligji.

Neni 24

Faturë elektronike për pagesa pa para në dorë

1. Fatura, e cila lëshohet për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në transaksionet në të cilat shitësi dhe blerësi janë tatimpagues të cilët janë subjekt të TVSH-së, ose të tatimit mbi fitimin, ose të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, në përputhje me ligjet e

fushës, duhet të lëshohet, dërgohet dhe pranohet si faturë elektronike, në përputhje me nenin 28, të këtij ligji, nëse fatura është paguar ose do të paguhet pa para në dorë.

2. Fatura elektronike sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të ketë të gjitha të dhënat e nevojshme dhe të lëshohet duke zbatuar procedurat e fiskalizimit të përcaktuara me këtë ligj, dhe duhet të jetë në përputhje me standardet evropiane dhe procedurat në kreun VIII të këtij ligji.

3. Fatura elektronike sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të dërgohet ose vihet në dispozicion të blerësit në momentin e furnizimit të mallrave ose shërbimeve, në përputhje me nenin 8, të këtij ligji.

4. Në rast të furnizimit të mallrave me transport, tatimpaguesi që lëshon faturë, sipas pikës 1, të këtij neni, detyrohet të lëshojë një faturë elektronike dhe të zbatojë procedurën e fiskalizimit menjëherë përpara kryerjes së transportit të mallrave, dhe të printojë në letër kodin QR me të dhënat e përcaktuara në udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat, dhe t'ia dorëzojë atë transportuesit. Transportuesi duhet ta ruajë këtë dokument gjatë tërë kohëzgjatjes së transportit të mallrave, nga nisja deri në destinacion, ose deri sa t'ia dorëzojë mallrat blerësit dhe, detyrohet me kërkesën e zyrtarëve të administratës tatimore, ta vendosë këtë dokument në dispozicion të tyre.

5. Në të gjitha transaksionet e tjera, kur nuk përmbushen kushtet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, dhe, kur në bazë të këtij ligji, ekziston detyrimi për të lëshuar faturë, fatura e cila është paguar ose do të paguhet pa para në dorë, mund të lëshohet si faturë elektronike. Blerësi mund, por nuk është i detyruar ta pranojë si faturë elektronike, prandaj, ajo mund të printohet në letër ose t'i dërgohet blerësit nëpërmjet postës elektronike (*e-mail*), me pëlqimin e tij. Përkrahimisht, pëlqimi i tij nuk është i nevojshëm nëse blerësi është i regjistruar në platformen qendror të faturave të përmendur në nenin 26, të këtij ligji.

6. Tatimpaguesi që lëshon faturë mund të lëshojë dhe dërgojë fatura sipas pikës 5, të këtij neni, kur lëshon faturë e cila paguhet pa para në dorë, në rastin e eksportimit të mallrave jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ose ofrimit të shërbimeve për blerësit jorezident.

7. Pëlqimi i blerësit, sipas pikës 5, të këtij neni, duhet të jepet me shkrim ose me marrëveshje gjatë përpunimit të faturës ose kryerjes së pagesës së faturës së pranuar, apo nëpërmjet regjistrimit në platformen qendrore të faturave.

Neni 25

Faturat elektronike në transaksionet me organet publike

1. Faturat në transaksionet me organet publike lëshohen, dërgohen dhe pranohen si faturë elektronike.

2. Detyrimi për të lëshuar faturë elektronike, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, nuk zbatohet për faturat e lëshuara si rezultat i ekzekutimit të një kontrate të prokurimit publik që përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit të prokurimit publik, dhe ku prokurimi dhe përmbushja e kontratës deklarohen të jenë sekrete ose duhet të shoqërohen me masa të veçanta të sigurisë në përputhje me ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative, si dhe me kusht që interesat me rëndësi të mos garantohen me masa më pak të ashpra..

Commented [A19]: Në momentin e lëshimit të faturës nga shitësi, të dhënat e blerësit (i cili mund të jetë i regjistruar në platformë) do të gjenerohen automatikisht në sistem? Apo të dhënat e faturave të blerjes do të përfshihen nga blerësi në platformën elektronike të faturave?

a. Nuk është e qartë mënyra e pranimit të faturës nga ana e blerësit në sistem;
b. nuk parashikohet rasti i refuzimit të një fature të lëshuar në sistem nga ana e subjektit tjetër (faturë e lëshuar gabimisht, shifra jo e saktë, pa dijeninë e këtij të fundit etj);

KREU VIII

DISPOZITA TË VEÇANTA PËR FATURAT ELEKTRONIKE

Neni 26

Platforma qendrore e faturave

1. AKSHI ngarkohet që të krijojë, zhvillojë, mirëmbajë dhe administrojë nga ana teknike platformën qendrore të faturave përmes së cilës do të shkëmbehen faturat elektronike.
2. Lëshuesit dhe pranuesit e faturave elektronike, janë të detyruar të regjistrohen në platformën qendrore të faturave, në fillim të ushtrimit të veprimtarisë së tyre ekonomike, ose brenda 24 orëve përpara fillimit të lëshimit ose pranimit, ose shkëmbimit të faturave elektronike nëpërmjet saj.
3. Të gjitha faturat elektronike duhet të shkëmbehen nëpërmjet platformës qendrore të faturave, pas zbatimit të procedurës së fiskalizimit, në përputhje me kreun VI, të këtij ligji.
4. Platforma qendrore e faturave është pjesë e infrastrukturës shtetërore të teknologjisë së informacionit që administrohet nga ana teknike nga AKSHI dhe të dhënat që shkëmbehen përmes kësaj platforme janë pronë e administratës tatimore.
5. Detyrimet ligjore që rrjedhin nga ky nen zbatohen në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe udhëzimet përkatëse të Ministrit përgjegjës për financat.

Neni 27

Procedura e thjeshtuar për lëshimin dhe pranimin e faturave elektronike dhe për fiskalizim për biznesin e vogël

1. Nëse lëshuesi apo pranuesi i faturave elektronike është tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, dhe/ose i nënshtrohet regjimit të bizneseve të vogla, sipas ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, në rast të lëshimit ose pranimit të detyrueshëm të faturës elektronike, sipas neneve 24 dhe 25, të këtij ligji, mundet të përpilojë dhe fiskalizojë faturat elektronike nëpërmjet platformës qendrore të faturave dhe, përmes seciles shkëmbehen faturat elektronike, në mënyrë që faturën elektronike t’ia dërgojë pranuesit të saj, ose të pranojë faturën elektronike nga tatimpaguesi që lëshon faturë elektronike.
2. Lëshuesit dhe pranuesit e faturave elektronike, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të pajisen me certifikatë elektronike, sipas nenit 19, të këtij ligji, gjatë shkëmbimit elektronik të të dhënave.
3. Përjashtimisht nga nenet 16, 18 dhe 20, të këtij ligji, lëshuesit e faturave elektronike sipas pikës 1, të këtij neni, nuk duhet të instalojnë pajisje të veçanta fiskale, apo një zgjidhje të veçantë softuerike për zbatimin e procedurës së fiskalizimit, apo të paraqesin informacion në lidhje me mirëmbajtësin e zgjidhjes softuerike.

4. Ministri përgjegjës për financat, me udhëzim, përcakton procedurat përkatëse për zbatimin e këtij neni.

Neni 28

Rregullat e përdorimit të faturave elektronike

1. Faturat elektronike të lëshuara nga tatimpaguesit që lëshojnë faturë, duhet të jenë në përputhje me kete ligj dhe standardin përkatës evropian. Standardi evropian është normë e nxjerrë nga Komiteti Evropian për Standardizim (CEN), më 28.06.2017, EN 16931-1: 2017.
2. Vërtetësia e origjinës, integriteti i përmbajtjes dhe lexueshmëria e faturave elektronike, duhet të sigurohen nga momenti i lëshimit deri në fund të periudhës së ruajtjes së faturës në formë elektronike.
3. Besueshmëria e origjinës sigurohet në mënyrë të tillë që lëshuesi është i identifikueshëm, ndërsa integriteti i përmbajtjes nënkupton që përmbajtja e faturës nuk është ndryshuar.
4. Termat dhe kushtet nga pikat 2 dhe 3, të këtij neni, tatimpaguesi që lëshon faturë, detyrohet t'i garantojë me anë të certifikates elektronike.
5. Ministri përgjegjës për financat, me udhëzim, përcakton zbatimin e këtij neni.

KREU IX

DISPOZITA TË VEÇANTA PËR PROCEDURËN E FISKALIZIMIT

Neni 29

Ndërprerja e lidhjes elektronike (internetit)

1. Përfshihet nga nenet 18, 20 dhe 21, të këtij ligji, në rast të ndërprerjes së lidhjes elektronike (internetit) të vendosur, tatimpaguesi që lëshon fatura duhet të lëshojë fatura me të dhënat e përcaktuara në kreun IV të këtij ligji, pa të dhënat e NIVF-së, ndërsa fatura duhet të printohet në letër.
2. Tatimpaguesi që lëshon fatura, duhet që brenda 48 orëve, duke filluar nga data e ndërprerjes së lidhjes, të vendosë një lidhje elektronike (interneti) dhe t'ia dorëzojë të gjitha faturat e lëshuara, sipas pikës 1, të këtij neni, administratës tatimore, nëpërmjet një protokollit të veçantë në përputhje me udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat, si dhe pranuesit të faturës elektronike në rastin e përmendur në nenet 24 dhe 25, të këtij ligji.
3. Faturat e lëshuara sipas pikës 1, të këtij neni, konsiderohen se janë fiskalizuar saktësisht, nëse procesi i fiskalizimit është kryer brenda afatit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni.
4. Në mënyrë që procesi i përcaktuar në pikat 1 deri në 3, të këtij neni, të jetë një përjashtim, tatimpaguesi që lëshon fatura, duhet të sigurojë softuer dhe harduer të përshtatshëm për shkëmbimin dhe dërgimin e të dhënave në administratën tatimore dhe lidhjen e përshtatshme elektronike (internetit).

Commented [A20]: Në mjaft zona rurale do të sillte problematike në aplikim si rrjedhojë e mundësive reale të infrastrukturës së shërbimit të internetit në këto zona dhe të cilat janë jashtë kontrollit të bizneseve. Për më tepër, ju lutem të mbajmë parasysh dhe faktin që jo të gjithë përgatitësit e faturave janë familjar me përdorimin e pajisjeve software.

5. Tatimpaguesi që lëshon faturë është përgjegjës për verifikimin e kapacitetit të duhur të rrjetit, që e përcakton në mënyrë të pavarur, bazuar në numrin e mesazheve për sekondë në momentin e ngarkesës maksimale.

6. Administrata tatimore i cakton një NIVF të gjitha faturave sipas pikës 2, të këtij neni, dhe ia kthen tatimpaguesit që lëshon faturë, si konfirmim të pranimit të faturave të dërguara me vonesë.

7. Nëse tatimpaguesi që lëshon faturë nuk mundet që në afatin e përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, të rivendosë lidhjen elektronike (internet), për arsye të nevojës për të ndryshuar pajisjen për vendosjen e lidhjes elektronike (internet), pamundësisë për të vendosur lidhjen elektronike (internet) për të cilën është përgjegjës ofruesi i këtij shërbimi, ose për arsye të forcës madhore, ai duhet të njoftojë administratën tatimore për këtë, dhe të dërgojë dokumentacionin ose provat e tjera që dëshmojnë pamundësinë e vendosjes së lidhjes elektronike (internet), sipas udhëzimit të Ministrit përgjegjës për financat.

8. Për faturat për të cilat nuk është përcaktuar detyrimi i dërgimit në formë elektronike, në përputhje me nenet 24 dhe 25, të këtij ligji, tatimpaguesi që lëshon faturë, duhet, me kërkesë të blerësit të lëshojë një kopje të faturës me NIVF, në përputhje me pikën 6, të këtij neni pasi është kryer procedura e mëvonshme fiskalizuese.

Neni 30

Ndërprerja e punës së pajisjes fiskale për zbatimin e fiskalizimit

1. Nëse ndodh ndërprerja e plotë e punës së pajisjes fiskale, sipas nenit 3, pika “gj”, e këtij ligji, tatimpaguesi që lëshon faturë, lëshon një faturë nga një bllok i veçantë faturash.

2. Përpara fillimit të përdorimit, blloku i veçantë i faturave, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të autorizohet nga administrata tatimore.

3. Në rastin e përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, lëshuesi i faturës detyrohet që brenda pesë ditëve, pas ditës kur pajisja fiskale ka ndaluar plotësisht së funksionuari, të mundësojë funksionimin e pajisjes për lëshimin e faturave fiskale ose të sigurojë një pajisje të re.

4. Brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, tatimpaguesi që lëshon faturë, detyrohet të fusë të gjitha faturat në sistemin fiskal dhe t'i paraqesë ato në administratën tatimore, nëpërmjet lidhjes elektronike (internetit), nëpërmjet një protokolli të veçantë në përputhje me udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat, si dhe pranuesit të faturave elektronike, në rastet e përcaktuara në nenet 24 dhe 25, të këtij ligji.

5. Në rast të përcaktimeve sipas pikës 4, të këtij neni, administrata tatimore i cakton të gjitha faturave të pranuar një NIVF, dhe ia kthen prapa tatimpaguesit që lëshon faturë si vërtetim për pranimin e faturave të dorëzuara me vonesë.

6. Tatimpaguesi që lëshon faturë detyrohet që menjëherë pas marrjes së NIVF-së, ta shkruajë atë në kopjen e faturës në bllokun e veçantë të faturave, sipas pikës 1, të këtij neni.

7. Për faturat për të cilat nuk është përcaktuar detyrimi për dorëzimin e faturave elektronike në përputhje me nenet 24 dhe 25, të këtij ligji, tatimpaguesi që lëshon faturë detyrohet që me

Commented [A21]: Njoftim për mos-vendosje të lidhjes elektronike apo shkaqeve për pamundësinë për të vendosur lidhjen elektronike. Si do të njoftohet administrata? Me shkrësë sqaruese, në mënyrë elektronike?

Commented [A22]: Çdo tatimpagues duhet të mbajë dhe një bllok faturash të autorizuar nga administrata tatimore në rast ndërprerjeje së pajisjes fiskale?

Commented [A23]: Duhet që brenda 5 ditëve (5 ditë pune apo 5 ditë kalendarike) të mundësojë funksionimin e pajisjes së faturës fiskale. Po nëse ky afat nuk përmbushet për shkaqe të ndryshme?

Gjithashtu mendojmë që në këtë nen duhet saktësuar edhe përgjegjësia që mban riparuesi i pajisjes fiskale në rast të tejkalimit të afateve ligjore për faj të tij.

Commented [A24]: Procesi i përcaktuar në këtë nen varet totalisht nga procesi i përcaktuar në pikën 3 të po këtij neni. Mendojmë që duhet rishikuar afati.

kërkesë të blerësit, të lëshojë një kopje të faturës me NIVF-në nga pajisja elektronike e faturimit, pasi është kryer procedura e mëvonshme fiskalizuese.

8. Ministri përgjegjës për financat, me udhëzim, përcakton përmbajtjen dhe procedurat e vërtetimit të bllokut të veçantë të faturave dhe procedurën e fiskalizimit të mëvonshëm të atyre faturave.

Neni 31

Zbatimi i procedurës së fiskalizimit në zonat ku nuk është e mundur të vendoset një lidhje për shkëmbimin e të dhënave

1. Nëse tatimpaguesi që lëshon faturë ushtron veprimtarinë tregtare në ambiente biznesi të cilat ndodhen në një zonë ku nuk është e mundur të vendoset lidhja elektronike (interneti) për shkëmbimin e të dhënave me administratën tatimore, tatimpaguesi që lëshon faturë do të zbatojë procedurën e fiskalizimit të faturave për atë pjesë të aktivitetit të tij tregtar nëpërmjet lëshimit të faturës me të dhënat e përcaktuara në kreun IV të këtij ligji, pa të dhënat e NIVF-së, dhe është i përjashtuar nga detyrimi për të lëshuar faturë elektronike, sipas neneve 24 dhe 25, të këtij ligji, deri sa të krijohet mundësia e lidhjes elektronike (internet).

2. Tatimpaguesi që lëshon faturë deklaron pamundësinë për të vendosur lidhjen elektronike (internet) për shkëmbimin e të dhënave në një zonë ku kjo nuk është e mundur dhe kjo deklaratë verifikohet nga administrata tatimore bazuar mbi informacionin nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me afat të vlefshmërisë prej një viti.

3. Tatimpaguesi që lëshon faturë, në rastin e përmendur në pikën 1, të këtij neni, detyrohet:

a) të dorëzojë në administratën tatimore të dhënat e përcaktuara në kreun V, të këtij ligji, nëpërmjet platformes qendrore të faturave ose drejtpërdrejt në zyrat përkatëse të administratës tatimore;

b) të pajiset me pajisje fiskale dhe zgjidhje softuerike, në përputhje me nenin 18, të këtij ligji;

c) të pajiset me certifikatë elektronike sipas nenit 19, të këtij ligji; dhe

ç) deri në datën 10 të muajit të paraqesë në administratën tatimore të gjitha faturat e lëshuara në muajin paraardhës, nëpërmjet një medie portative ruajtëse, ose nëpërmjet shërbimit elektronik të administratës tatimore.

4. Administrata tatimore u cakton NIVF-në të gjitha faturave të paraqitura sipas pikës 3, shkronja “ç” të këtij neni, dhe ia kthen prapa tatimpaguesit që lëshon faturë si vërtetim i pranimit të faturave të paraqitura me vonesë.

5. Tatimpaguesi që lëshon faturë, detyrohet që të shtojë NIVF-në e marrë nga administrata tatimore sipas pikës 4 të këtij neni, nëpërmjet zgjidhjes softuerike që përdor në pajisjet fiskale për lëshimin e faturave, të gjitha faturave të lëshuara, brenda 5 ditësh nga marrja e NIVF-së.

6. Me kërkesë të blerësit, tatimpaguesi që lëshon faturë detyrohet t’i japë atij një kopje të faturës me NIVF-në në përputhje me pikën 5, të këtij neni.

Commented [A25]: Në kushtet e shpërndarjes demografike duket e vështirë të zbatohet në praktikë për këto zona, do të sillte kosto shtesë biznesi, mundësi abuzimi nga një kategori inspektorësh tatimore.

Commented [A26]: Kjo kategori tatimpaguesi do të raportojë çdo muaj faturat e lëshuara në modulën e veçantë dhe do të presi nga administrata tatimore vërtetimin për pranimin e faturave?

Commented [A27]: Pas 5 ditëve nga marrja e miratimit nga administrata do të vendosë numrat e NIVF për çdo faturë të lëshuar. Si do të procedohet për ato tatimpagues të cilët kanë marrë faturat pa nr. NIVF nga ky subjekt?

Commented [A28]: Për këtë kategori të faturave, blerësi do procedojë me deklarimin një muaj me vonesë? Duke qenë se miratimi i numrit NIVF do të gjenerohet me vonesë.

7. Ministri përgjegjës për financat, nxjerr udhëzim për procedurën e sigurimit të provave në rast të pamundësisë për të vendosur një lidhje elektronike (internet) për shkëmbimin e të dhënave, detyrimeve të tatimpaguesit që lëshon faturë sipas këtij neni, dhe mënyrës në të cilën dërgohen të dhënat e përcaktuara në pikat 3 dhe 4, të këtij neni.

Neni 32

Fiskalizimi i faturave korrigjuese

1. Të gjitha detyrimet e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji për lëshimin e faturave zbatohen sipas nevojës edhe për lëshimin e faturave korrigjuese, për faturat e kthimit të pjesshëm apo të plotë të mallit dhe/ose saktësimin e vlerës së shërbimit. Fiskalizimi është njësoj i mundshëm edhe për faturat që shënojnë shuma negative.

2. Fatura korrigjuese duhet të përmbajë një referencë tek fatura origjinale që korrigjohet.

Neni 33

Njoftimi për faturën

1. Tatimpaguesi që lëshon faturë, detyrohet të afishojë një njoftim në secilën pajisje elektronike të pagesës ose në një vend tjetër të dukshëm në ambientet e brendshme të biznesit, që tregon detyrimin për të lëshuar faturën, si dhe detyrimin e blerësit për të marrë dhe ruajtur faturën.

2. Përjashtimisht nga pika 1, e këtij neni, tatimpaguesi që lëshon faturë, i cili zbaton procedurën e fiskalizimit të shitjeve nëpërmjet pajisjeve të vetëshërbimit (automat), është i detyruar të afishojë në çdo pajisje të tillë njoftimin për fiskalizimin e shitjeve nëpërmjet këtyre pajisjeve.

3. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim përmbajtjen dhe pamjen e njoftimit të përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 34

Detyrimet e blerësit

1. Blerësi, ose çdo marrës i faturës të lëshuar për pagesë me para në dorë, është i detyruar të mbajë me vete faturën e lëshuar pas largimit nga vendi i ushtrimit të veprimtarisë së biznesit.

2. Nëse i kërkohet, blerësi, sipas pikës 1 të këtij neni, është i detyruar t'i tregojë faturën e lëshuar, personit të autorizuar administratës tatimore.

Neni 35

Verifikimi i faturës

1. Të gjithë blerësit ose marrësit e faturave për të cilat është kryer procedura e fiskalizimit, mund të verifikojnë nëse fatura e tyre është raportuar në administratën tatimore deri në 60 ditë nga data e lëshimit të faturës.
2. Verifikimi bëhet nëpërmjet platformes qendrore të faturave, ose duke skanuar kodin QR në faturë.
3. Faturat e lëshuara në rastet e përcaktuara në nenet 29, 30 dhe 31, të këtij ligji, blerësi ose marrësi i faturës, mund t'i dorëzojnë në zyrat përkatëse të administratës tatimore për qëllime verifikimi.
4. Ministri përgjegjës për financat me udhëzim përcakton mënyrën e verifikimit të faturave të lëshuara sipas këtij neni.

Neni 36

Ruajtja e faturave

Tatimpaguesi që lëshon faturë duhet të marrë masa për ruajtjen e faturave sipas përcaktimeve të ligjit "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë".

KREU X

RREGULLIMI I PAGESAVE ME PARA NË DORË

Neni 37

Detyrimi për të depozituar paratë (kartëmonedhat dhe monedhat) në llogari bankare

1. Tatimpaguesi që lëshon faturë detyrohet që paratë që ka grumbulluar gjatë ditës mbi çfarëdo baze, që tejkalojnë nivelin e caktuar maksimal të arkës, në përputhje me nenin 38, të këtij ligji, t'i depozitojë në llogarinë bankare në të njëjtën ditë, dhe jo më vonë se ditën e ardhshme të punës.
2. Tatimpaguesi që lëshon faturë, të cilit i janë bllokuar llogaritë e biznesit për mospagim të detyrimeve, nuk mund të paguajë me para në dorë ose të mbajë para në arkë, por duhet që këto para t'i depozitojë menjëherë në llogarinë bankare për veprimtarinë e rregullt të biznesit, dhe jo më vonë se ditën e ardhshme të punës.

Neni 38

Limiti i arkës

Commented [A29]: Ruajtja e faturave do të jetë edhe në formë elektronike?

Commented [A30]: Nenet 37 & 38 për arsye ligjore dhe praktike të zbatimit të tij i kontestojmë dhe shprehim opinion tonë që duhen ripare:

- a. Nuk gjejmë ndonjë referencë të direktivës europiane për vendosje limitesh në arke;
- b. Janë një numër i konsiderueshëm Bashkish (rreth 20% e numrit të përgjithshëm) të cilat nuk kanë prezencë të asnjë dege të vetme Banke në territorin e tyre, çka praktikisht e bën të pamundur aplikimin e këtyre neneve;
- c. Janë një numër i konsiderueshëm Bashkish që kanë një prezencë shumë të ulët të bankave (me mjaft raste me një dege ose maksimumi 2 të tilla), çka praktikisht përsëri do ta bënte të vështirë aplikimin në praktikë të këtyre neneve të këtij ligji;
- d. Brenda territorit të bashkive (përfshirë edhe bashkitë kryesore si Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Shkodër etj) ka mjaft njësi administrative të cilat nuk kanë prezencë Banke dhe gjithashtu janë fizikisht në distancë të konsiderueshme larg qendrës së Bashkisë e cila mund të ketë prezencë të një dege banke, duke e bërë të pamundur zbatimin në praktikë të këtyre neneve;
- e. Limitime të sforcuara do të krijojnë kosto të shtuara për bizneset (kosto në kohe fizike, kohë pritje, kosto transporti, kosto të shtuara bankare, risk i shtuar, veprime fiktive depozitimi dhe tërheqje në të njëjtën kohë krejtësisht të panevojshme etj);
- f. Sektorë të ndryshëm të ekonomisë kanë specifikat/karakteristikat e tyre dhe është e pamundur të përgjithësohen me 3-4 nivele limitesh;
- g. Duke krijuar hapsirë për kontrole fizike në arkat e bizneseve/kompanive do të krijohet potencial/hapsirë për abuzime nga një kategori inspektorësh tatimore.

1. Tatimpaguesi që lëshon faturë, përveç në rastet e përcaktuara në nenin 37, pika 2, të këtij ligji, mund të mbajë para kesh (kartëmonedha dhe monedha), në fund të ditës së punës, deri në shumën maksimale të arkës. Shumën maksimale të parave kesh e përcakton tatimpaguesi që lëshon faturë, në mënyrë të pavarur, duke nxjerrë një akt të brendshëm, në përputhje me nevojat dhe kushtet e sigurisë, por kjo nuk mund të jetë më shumë se maksimumi i përcaktuar në pikën 2, të këtij neni.

2. Kriteret për përcaktimin e shumës së maksimumit të arkës së tatimpaguesit që lëshon faturë, janë madhësia e tatimpaguesit që lëshon faturë, në përputhje me legjislacionin tatimor. Bazuar në këtë kriter, tatimpaguesi që lëshon faturë, mund të caktojë shumën maksimale të parave kesh në arkë, në mënyrën e mëposhtme:

- a) tatimpaguesit me qarkullim vjetor në vitin e kaluar deri në 2 milionë lekë deri në 50000 lekë;
- b) tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi 2 milion deri në 14 milion lekë deri në 300000 lekë;
- c) tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi 14 milion lekë deri në 800 000 lekë.

3. Maksimumi i arkës përcaktohet për tatimpaguesin që lëshon faturë në tërësi, dhe brenda kësaj shume, tatimpaguesi që lëshon faturë, mund të përcaktojë maksimumin e parave në arkë, sipas njësive të organizimit.

4. Me përjashtim të përcaktimit në pikën 3, të këtij neni, tatimpaguesi që lëshon faturë, mund të përcaktojë maksimumin e arkës për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, por deri në maksimumin prej 250 000 lekë.

5. Tatimpaguesi që lëshon faturë, i cili kryen transaksione këmbimi monedhe, pavarësisht nga dispozitat e pikave 2, 3 dhe 4, të këtij neni, mund të përcaktojë maksimumin e arkës deri në shumën prej 1 700 000 lekë.

6. Tatimpaguesi që lëshon faturë, detyrohet në fillim të çdo dite pune, dhe para lëshimit të faturës së parë, nëpërmjet lidhjes elektronike të vendosur me administratën tatimore, lidhje të cilën e përdor për zbatimin e procedurës së fiskalizimit, të paraqesë informacionin mbi shumën fillestare të parave në dorë në arkë (depozitave), për çdo pajisje elektronike të faturimit, në përputhje me udhëzimin e Ministrit përgjegjës për financat.

Commented [A31]: Kjo do të ketë një rritje të punës për çdo tatimpagues për regjistrimin e të gjithë transaksioneve dhe raportimin e vlerës së arkës për çdo pikë shitje. Si do aplikohet për subjektet që punojnë me turne 24h?

KREU XI

REGJISTRIMI I TË DHËNAVE PËR PAGESAT PA PARA NË DORË

Neni 39

Subjektet dhe procedurat për regjistrimin e pagesave pa para në dorë

1. Bankat, institucionet e tjera financiare dhe ndërmjetësit e tjerë të cilët ofrojnë shërbime të pagesave pa para në dorë të faturave elektronike të lëshuara, për të cilat tatimpaguesi që lëshon faturë ka zbatuar procedurën e fiskalizimit, detyrohen të regjistrojnë pagesat e kryera

dhe, për këtë, në mënyrë elektronike, të njoftojnë administratën tatimore menjëherë pas kryerjes së pagesës.

2. Për qëllim të regjistrimit të pagesës, subjektet e përmendur në pikën 1, të këtij neni, detyrohen të instalojnë një zgjidhje softuerike të certifikuar ose sistem të integruar kompjuterik të certifikuar, ose të përdorin aplikacionin në ueb certifikuar (Cloud), i cili mundëson lidhjen e faturave elektronike të lëshuara dhe të dhënave të pagesës, si dhe sistemin e komunikimit ndërmjet tatimpaguesit që lëshon faturë dhe administratës tatimore, nëpërmjet rrjetit të sigurtë për transferimin elektronik të të dhënave nëpërmjet lidhjes elektronike (internetit).

3. Subjektet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, regjistrohen në sistemin fiskal të shkëmbimit të mesazheve mbi pagesat e realizuara, nëpërmjet një certifikate elektronike, në përputhje me nenin 19, të këtij ligji, dhe, kur të kryejnë pagesat e faturave elektronike në emër dhe për llogari të tyre, dhe në emër dhe për llogari të klientëve, të dërgojnë një mesazh në administratën tatimore për pagesat e kryera, nëpërmjet lidhjes elektronike (internetit).

4. Të dhënat, të cilat për nevojat të regjistrimit të pagesave i dërgohen administratës tatimore, sipas mënyrës së përcaktuar në pikën 1, 2 dhe 3, të këtij neni, ndër të tjera, duhet patjetër të përmbajjnë elementet e mëposhtme:

a) numrin unik të identifikimit të personit që paguan faturën (blerësit);

b) numrin unik të identifikimit të subjektit sipas pikës 1 të këtij neni;

c) NIVE-në e faturës së paguar, apo në raste të veçanta NSLF-në, nëse në faturë nuk ka NIVF, sipas përcaktimeve në nenin 29, të këtij ligji;

c) shumën e paguar;

d) datën e pagesës.

5. Nëse subjektet sipas pikës 1, të këtij neni, nuk kanë në dispozicion të gjitha të dhënat e përmendura në pikën 4, të këtij neni, detyrohen të marrin këto të dhëna nga blerësi dhe, në atë rast, nuk kryejnë pagesën derisa blerësi të paraqesë të gjitha të dhënat e kërkuara.

6. Pas marrjes së mesazhit elektronik, administrata tatimore kontrollon në mënyrë automatike nëse janë dërguar të gjitha të dhënat e kërkuara, nëse të dhënat janë të sakta dhe, pastaj, regjistron në bazën e saj të të dhënave kryerjen e pagesës së faturës elektronike së fiskalizuar. Pas kryerjes së kontrollit, administrata tatimore u kthen subjekteve të referuar në pikën 1, të këtij neni, mesazhin mbi pranimin me sukses të informacionit për pagesën, nëpërmjet lidhjes elektronike të vendosur (internet).

7. Nëse ajo konstaton që nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara në pikën 6, të këtij neni, administrata tatimore i kthen mesazh subjektit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, për regjistrimin e pasuksesshëm të pagesës së bashku me një shpjegim për gabimet, nëpërmjet lidhjes elektronike të vendosur (internet). Nëse konstatohet ndonjë gabim si pasojë e fajit të ndërmjetësit financiar, ky detyrohet të korrigjojë gabimin dhe të përsërisë procedurën, por nëse gabimi nuk është shkaktuar me fajin e tij, ai detyrohet që për këtë të informojë blerësin ose paguesin e faturës, brenda 24 orëve nga pranimi i mesazhit. Blerësi ose paguesi detyrohet

Commented [A32]: Bankat do të kenë dhe një sistem tjetër për regjistrimin e pagesave të lidhur me modulën e faturave elektronike?

Commented [A33]: Duhet qartësuar se çfarë i referohet saktësisht me "numrin unik të identifikimit të personit që paguan faturën (blerësit)!... A i referohet ky numer "NIPT" të subjektit të faturuar dhe që duhet të paguajë faturën? I referohet personit që inicion pagesën e faturës (paguesi i faturës në shumë raste është i ndryshëm nga blerësi)? Po në rastet kur blerësi (për të cilin është lëshuar fatura) është individ dhe nuk ka NIPT, çfarë të dhënash duhen vendosur (sugjerojmë që në këto raste faturash NIFV e faturës së paguar do të mjaftonte për kryerjen e pagesës)?

Commented [A34]: Për çdo njoftim Administrata miraton pagesën? Si do të verifikohet pagesa nga administrata?

të korrigjojë gabimin dhe për këtë të informojë ndërmjetësin financiar, i cili duhet të përsëritë procedurën sipas pikës 3, të këtij neni.

8. Përjashtimisht nga pika 1 e këtij neni, nëse pagesa është kryer nëpërmjet një ndërmjetësi që nuk i ka zyrat kryesore apo selinë e përhershme, ose përfaqësuesin tatimor ose adresën e përhershme apo vendbanimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, nëse pagesa pa para në dorë kryhet nga vetë blerësi pa ndërmjetës ose nëse pagesa kryhet në bazë të ofertës dhe përpara lëshimit të faturës elektronike, në përputhje me nenin 7, pika 1, të këtij ligji, atëherë, vetë tatimpaguesi që lëshon faturë duhet që nëpërmjet platformes qendrore të faturave, të regjistrojë të gjitha pagesat e pranuar, jo më vonë se ditën e 10-të të muajit pasardhës për të gjitha pagesat e kryera në muajin paraardhës.

9. Sipas mënyrës së përcaktuar në pikën 8, të këtij neni, tatimpaguesi që lëshon faturë detyrohet të veprojë edhe në rast të kryerjes së pagesës nëpërmjet shkëmbimit, transferimit të drejtave ose borxheve, heqjes dorë nga detyrimi, etj.

10. Të dhënat e pagesës sipas këtij neni dërgohen për të gjitha pagesat, pavarësisht nëse është paguar e gjithë shuma e faturës ose vetëm një pjesë e saj. Përjashtimisht, tatimpaguesi që lëshon faturë, i cili regjistron vetë pagesat e blerjes, në përputhje me pikën 8, të këtij neni, shënon shumën totale të regjistruar për secilën faturë të muajit paraardhës.

11. Të gjitha detyrimet e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe në rast të anulimit apo ndryshimit të pagesës së bërë dhe për rimbursimin e pjesshëm ose të plotë të shumës së paguar për një faturë elektronike të caktuar. Nëse bëhet rimbursim i shumës së paguar, dërgohet një mesazh me të njëjtin informacion sipas pikës 4, të këtij neni, me parashenjë të shumës negative të shumës së kthyer.

12. Specifikimet teknike të zgjidhjes softuerike, si dhe procedurat e regjistrimit të informacionit nga vetë tatimpaguesi që lëshon faturë, do të përcaktohen me urdhër të përbashkët të Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

KREU XII

FATURA SHOQËRUESE

Neni 40

Tatimpaguesit që lëshojnë faturë shoqëruese

1. Tatimpaguesit që lëshojnë faturë shoqëruese janë tatimpagues që lëshojnë faturë, kur ato transportojnë mallra nga një vend në një tjetër në territorin e Republikës së Shqipërisë, pa ndryshim të pronësisë.

2. Qëllimi i lëshimit të faturës shoqëruese nuk është krijimi i detyrimit tatimor, por monitorimi i lëvizjes së mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Fatura shoqëruese lëshohet nga tatimpaguesi që lëshon faturë sipas pikës 1, të këtij neni, menjëherë përpara transportit të mallit nga një vend në një tjetër në territorin e Republikës së Shqipërisë. Fatura shoqëruese origjinale, riprodhuar si kod QR, duhet të shoqërojë lëvizjen e mallrave deri në destinacion.

4. Tatimpaguesit që lëshojnë faturë shoqëruese nuk duhet të regjistrohen në mënyrë të veçantë në regjistrin e administratës tatimore përpara fillimit të lëshimit të faturës shoqëruese, por duhet të regjistrojnë vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit nga kryhet dërgimi i mallrave. Dispozitat e nenit 14, të këtij ligji, zbatohen në mënyrë të duhur edhe për ta.

5. Tatimpaguesit që lëshojnë faturë shoqëruese duhet të regjistrojnë operatorin i cili lëshon faturën shoqëruese. Dispozitat e nenit 15, të këtij ligji, zbatohen edhe për ta.

6. Tatimpaguesit që lëshojnë faturë shoqëruese duhet të regjistrojnë mirëmbajtësin e zgjidhjes softuerike. Dispozitat e nenit 16, të këtij ligji, zbatohen në mënyrë të duhur edhe për ta.

Neni 41

Të dhënat e detyrueshme të faturës shoqëruese

1. Fatura shoqëruese duhet të përpilohet në formën e përcaktuar me udhëzim të Ministrit përgjegjës për financat dhe duhet të përmbajë të paktën të dhënat e mëposhtme:

- a) titullin “Faturë Shoqëruese”;
- b) datën dhe kohën e lëshimit të faturës shoqëruese (orën dhe minutat);
- c) numrin e faturës shoqëruese;
- ç) numrin unik të identifikimit të tatimpaguesit që lëshon faturën shoqëruese;
- d) emrin tregtar/emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit që lëshon faturën shoqëruese;
- dh) adresën e nisjes së mallrave;
- e) adresën e destinacionit të mallrave;
- ë) kodin e operatorit, sipas nenit 3, pika “h”, e këtij ligji, të lëshuar në përputhje me nenin 15, të këtij ligji;
- f) kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, sipas nenit 3, pika “g”, të këtij ligji, të lëshuar në përputhje me nenin 14, të këtij ligji;
- g) datën e transportit të mallrave;
- gj) sasinë dhe përshkrimin e mallrave që transportohen;
- h) emrin tregtar/emrin dhe mbiemrin, adresën dhe numrin unik të identifikimit të transportuesit (nëse transportuesi është i ndryshëm nga tatimpaguesi që lëshon faturë);
- i) numrin e targave të automjetit me të cilin transportohen mallrat;
- j) numrin identifikues të veçantë të faturës shoqëruese (NIVFSH), i shprehur si shenjë alfanumerike;
- k) numrin e sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese (NSLFSH), i shprehur si shenjë alfanumerike; dhe
- l) Kodin QR që përmban të dhënat e përcaktuara me udhëzim të Ministrit përgjegjës për financat.

2. Tatimpaguesi që lëshon faturën shoqëruese, pasi procedura e fiskalizimit është kryer me sukses, duhet të printojë vetëm kodin QR, sipas pikës 1, shkronjës “I”, të këtij neni, dhe t’ua tregojë atë punonjësve të administratës tatimore nëse i kërkohet.

3. Neni 12 i këtij ligji zbatohet në mënyrën e duhur edhe për përcaktimin e numrit të faturës shoqëruese.

Neni 42

Zbatimi i procedurës së fiskalizimit të faturës shoqëruese

1. Tatimpaguesit që lëshojnë faturë shoqëruese duhet të instalojnë pajisjen elektronike dhe printer (nëse pajisja dhe printeri nuk janë të integruara), apo të përdorin softuerin e certifikuar të shoqëruar me një pajisje printimi, për printim të kodit QR dhe faturës shoqëruese, si dhe zgjidhjen softuerike, referuar në nenin 3, pika “gj”, të këtij ligji, dhe të sigurojnë lidhjen elektronike (internet) për shkëmbimin elektronik të të dhënave me administratën tatimore, në mënyrë që të kryhet procedura fiskalizuese për lëshimin e faturës shoqëruese.

2. Dispozitat e procedurës së fiskalizimit, të përcaktuara në nenet 18 dhe 20, të këtij ligji, dhe dispozitat e veçanta për procedurën fiskalizuese të referuar në nenet 29, 30 dhe 31 të këtij ligji, duhet të zbatohen në mënyrën e duhur për tatimpaguesit që lëshojnë faturë shoqëruese në procedurën e fiskalizimit të faturave shoqëruese.

3. Certifikata elektronike e përmendur në nenin 19, pika 1, e këtij ligji, përdoret dhe për lëshimin e faturës shoqëruese.

Neni 43

Detyrime të tjera

1. Përpara transportit të mallrave nga një vend i ushtrimit të veprimtarisë së biznesit të tatimpaguesit tek një tjetër, kodi QR i faturës shoqëruese duhet të printohet në letër, dhe duhet të shoqërojë mallrat gjatë gjithë kohës së transportit nga vendi i nisjes deri në destinacion.

2. Me kërkesë të punonjësit të administratës tatimore, tatimpaguesi ose transportuesi, duhet të tregojë kodin QR të faturës shoqëruese.

3. Kodi QR i faturës shoqëruese lëshohet në të paktën dy kopje, nga të cilat një mbahet në vendin e nisjes dhe tjetra në vendin e destinimit të mallrave.

4. Tatimpaguesi që lëshon fatura shoqëruese, duhet t’i ruajë këto për të paktën pesë (5) vjet, duke filluar nga fundi i vitit fiskal, të cilit i përkasin dokumentet, ose në të cilin janë lëshuar faturat shoqëruese të printuara në letër apo të lëshuara në formë elektronike.

KREU XIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 44

Autoriteti përgjegjës

Mbikqyrja e zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij kryhet nga administrata tatimore, në mënyrën dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligjin që rregullon procedurën tatimore dhe aktet zbatuese të miratuara në bazë të këtij ligji.

Neni 45

Dispozitat e sanksioneve

Për moszbatimin e dispozitave të këtij ligji apo çdo veprim, mosveprim apo shkelje, që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, aplikohen sanksionet dhe dënimet sipas përcaktimeve në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 46

Mbrojtja e të dhënave

1. Të dhënat personale të mbledhura për qëllim të lëshimit të faturës dhe kryerjes së regjistrimeve të pagesave, mund të përdoren vetëm për këtë qëllim ose për qëllime të tjera, që janë në përputhje me qëllimin e mbledhjes së këtyre të dhënave.
2. Marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet blerësit ose klientit dhe ndërmjetësve të teknologjisë së informacionit dhe/ose subjekteve që janë lëshues të faturës dhe ofrues të shërbimeve të teknologjisë së informacionit, në rolin e administratorit dhe përpunuesit të të dhënave personale, të dhëna të cilat përpunohen gjatë procedurës së lëshimit, marrjes, dërgimit, ruajtjes dhe përpunimit të faturave, rregullohen në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe ligjet e tjera të fushës.
3. Të gjitha çështjet e tjera që nuk mbulohen nga ky ligj, i nënshtrohen dispozitave të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, dhe dispozitave përkatëse të ligjeve të tjera të fushës.

Neni 47

Dispozitat kalimtare për tatimpaguesit e rinj të regjistruar

Nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të gjithë tatimpaguesit e rinj të regjistruar, të cilët më parë ishin të detyruar të instalonin një pajisje fiskale për lëshimin e kuponave tatimorë, në përputhje me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve të tjera ligjore të nxjerra në zbatim të këtyre ligjeve, **ky detyrim shfuqizohet, dhe në vend të kuponëve tatimorë lëshohen dëftesa tatimore.**

Commented [A35]: Si do të raportohen në sistemin e faturave dëftesat tatimore?

Neni 48

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohen Këshilli i Ministrave, Ministri përgjegjës për financat, Drejtorit i Përgjithshëm i AKSHI-t për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, jo më vonë se 30 ditë nga data e botimit të këtij ligji në Fletoren Zyrtare.

Neni 49

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe fillon të zbatohet nga data 1.1.2020, me përjashtim të dispozitave për përdorimin e faturave elektronike në transaksionet me organetpublike të përcaktuar në nenin 25, të këtij ligji, që fillojnë të zbatohen nga data 1.1.2021, të dispozitave për faturat elektronike për pagesat pa para në dorë të përcaktuar në nenin 24, të këtij ligji dhe të regjistrimeve të pagesave pa para në dorë në nenin 39 të këtij ligji, që fillojnë të zbatohen nga data 1.7.2021.

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI